

BIBLIOTEKA

E

854 - 32

SHTETIT

Q 40

GJIROKASTER

KOÇO QENDRO

# operacioni i një plage të vjetër

TREGIME

854-32

Q ko

5

KOÇO QENDRO

OPERACIONI  
I NJË PLAGE TË VJETËR

*T r e g i m e*

~~55496~~ 2890

BIBLIOTEKA E SHËTIT  
GJIROKASTER

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NË KTHETRAT E SHQIPONJAVE

Ishte fillimi i stinës më të bukur të vitit. Retë e zeza, që patën sjellë furtuna e rrebeshe, u zhdukën larg-larg, tutje, mbrapa maleve të lashta. Në ditët që agonin, dalngadalë nisi të tretej akulli e dëbora. Uji i kristaltë ja mori vrapit duke gurgulluar poshtë grykave. Toka e dëshiruar për rrezet e ngrohta të diellit jetëdhënës, lëshoi filizat e parë të gjelbërimit.

Një erë e freskët, që të mbushte kraharorin, një erë e pastër që të përtërinte, filloi të ndihej kudo!...

... Por në zyrat e hetuesisë, shoferi i taksisë, që i dallohej shenja e një plage të vjetër në faqen e majtë, zbërtheu jakën e xhakaventos prej meshini, se ndjeu zagushi. Atij i thahej pështyma në fyt përherë e më shumë. Kjo kishte arësye të forta. Gjatë gjithë seancave që e kishin marrë në pyetje kishte rezistuar me të madhe: «Më keni arrestuar kot së koti!», po më vonë i ndodhur para fakteve, ai kishte pranuar akuzën dhe ishte shtërnguar të pohonte të dhëna plotësonjëse që hidhnin dritë mbi veprimtarinë e tij armiqësore. Midis të tjerash, kishte nxjerrë në shesh dhe lidhjet që kishte patur me atë

person, fotografinë e të cilit oficeri i sigurimit ja zgjati ndihmësit të tij duke i thënë:

— E njihni këtë, shoku Dhori?

— Jo — tha ai si e vërejti me kujdes.

— Është numri që së fundi ka nxjerrë kokën në arenë — u përgjegj oficeri, buzëgaz, duke shfle-tuar dokumentat e vendosura në dosjen që kishte përpara.

— Stefanaq Kurrizi? — pyeti punëtori opera-tiv.

— Dora vetë. Këtej e tutje, për ne, ky do të je-të shtatëmbëdhjeta! Vëreje me kujdes e kije para-sysh. Me këtë numër do të kemi të bëjmë — e mbyl-li bisedën oficer Skënderi, shefi i degës, që së ba-shku me kolegun e tij, ndiqnin zhvillimin e ngjar-jeve.

\* \* \*

Si çdo ditë edhe atë mëngjez, që nga kreshta e malit hijerëndë, dielli lëshoi me shkëlqim rrezet e tij mbi gjelbërimin që kishte mbuluar vendin ane-nbanë. Refleksi i atyre rrezeve në pikat e vesës së natës u shtonte edhe më shumë bukurinë luleve, që porsa kishin çelur. Nga ai shkëlqim dukej sikur ato po përshëndesnin të gëzuara një shqiponjë që fluturonte krenare aty lart në qiellin, e kaltër.

Shpendi filloi të ngrihej gjithnjë e më lart. Kë-shtu u largua deri tutje në horizont e pastaj u kthye përsëri. Kur po fluturonte krejt i qetë, papritur mblo-dhi krahët dhe, si ndonjë shigjetë, u lëshua poshtë në luginë. Mbas pak u ngrit në fluturim fitimtar. Në kthetrat e tij, një gjarpër i madh lëkundej i

tmerruar. E ngriti lart e më lart e pastaj e lëshoi. Gjarpëri, si u përplas për tokë, nuk arriti të bënte as përpëlitjet e fundit, se edhe një herë u mbërthye nga ato kthetra të fuqishme, që e shtërnguan si në darë dhe e copëtuan aty, majë shkëmbit të madh!..

«Sa shpend i tmerrshëm!» tha me vete ai që e pa atë skenë, i strukur aty te hyrja e guvës së errët, dhe sepse ndjeu në trup një rrënqethje të ftohtë. Pa e kuptuar as vetë shkakun, këmba-dorazi, filloi të fshihej nëpër shkurret që kishte aty pranë.

Kështu, ndërsa majë shkëmbit të thepisur ngelën mbeturinat e gjarpërit të copëtuar, një «zvaranik» tjetër rrëshqiti nëpër pyllin e dendur, me shpresë se do t'i shpëtonte syrit të mprehtë të shqiponjave!

\* \* \*

Ai hyri në qytet së bashku me errësirën e natës. Nën ndriçimin e llambave neon, ecte i shkujdesur, si një njeri që as interesohet fare për ata që i kalonin pranë. Megjithatë, në kundërshtim me dëshirën e vet, aty-këtu e ngadalësonte hapin dhe pa rënë në sy vërente ndërtesat e reja, dhe rrugët.

Sa kish ndryshuar ky qytet brenda atyre pak viteve! Vendin e dyqaneve të vogla si furriqe pulash e kishin zënë bloqet e ndërtesave shumëkatëshe, e kishin zënë magazinat popullore. Rrugicat e ngushta të shtruara me kalldrëm, ishin mbuluar nga bulevardet e gjera me trotuare.

Si kaloi nëpër njerin nga këto bulevarde, ai

preu më të majtë e hyri në një rrugicë. Këtu shpejtoi hapin. Tej kryqëzimit të rrugëve mori më të djathtë e mbas një copë udhe ndaloi para portës së një shtëpie dykatëshe, oborri i së cilës ishte i rrethuar me mur prej tullash. Aty ktheu kokën mbra-pa, sikur desh të shikonte rrugën nga kishte ardhur, pastaj, si kontrolloi edhe një herë numrin e portës, trokiti me ngadalë...

Heshtje... Trokiti edhe një herë pak më fort.

— Urdhëroni! Kush është?... — u dëgjua një zë gruaje që nga brenda.

— Jam një shok i Stefanaqit. Aty është? — pyeti ai që trokiti.

— Këtu është, këtu — u përgjegj ajo.

— Ju lutem, i thoni të dalë pak.

— Ja, tani — tha gruaja dhe brenda u dëgjua një bisedë e mbytur. U ndezën dritat e sofatit. Kur u hap dera, nga shtëpia doli një burrë shkurtalaq, thatanik e me kokën pothuajse tullë. Ai kopsiti xhaketën e bizhamave, rregulloi pandoflat e leshta dhe, si zbriti nga shkallët në oborr, filloi të shante ata «të paedukatë» që atë ditë na i kishin prishur me top lulen «ROZMARI», që e shoqja e ruante si sytë e ballit. S'desh që ta tregonte inatin para atij që e priste jashtë, prandaj, kur po hapte portën, u mundua të dukej i qeshur, siç e kërkonte edukata. Kështu, pa e parë se kush ishte ai që e kërkonte, tha:

— Urdhëroni!.. Urdhëroni!..

Ai që ndodhej para tij, duke përkulur pak kokën përpara, e përshëndeti:

— Mirëmbërëma!

— Mi..mi..mirë..mbrëma — u përgjigj edhe i

zoti i shtëpisë, që u mbërthye si më gozhda nga prania e papritur e këtij njeriu, të cilin kishte vjete që nuk e kishte parë dhe që e dinte se prej nga vinte. I porsaardhuri nuk priti që ta ftonin po hyri brenda dhe mbylli portën.

— Si je, shoku Stefanaq? — e pyeti ai dhe i zgjati dorën për ta përshëndetur. Stefanaqi s'levizi fare.

— Aha! Sonte ta zura, më ke për darkë, shoku Stafanaq — tha me shaka mysafiri, por prapë i zoti i shtëpisë nuk u përgjegj.

— Kam një porosi nga drejtori i ndërmarrjes — vijoi i porsaardhuri duke marrë një qëndrim serioz. Mbas ngurrimit të shkurtër, si përpëliti sytë, burri me bizhama, i vuri llozin portës dhe u drejtua për në shtëpi, pa i dhënë përgjegje. Mysafiri e ndoqi nga mbrapa. Hynë në dhomën e pritjes e të dy qëndruan të heshtur, sikur t'i kishin mbaruar të gjitha fjalët e të mos kishin më çfarë të bisedonin.

— Po!.. Gjithë kjo shtëpi dhe s'paska vend! — tha si me vete mysafiri. I zoti i shtëpisë, që e dëgjoi, diçka murmuriti.

— Hë! Mos deshët të thoshit gjë?

— Desha të them: Pse erdhët tek unë? — tha tullaci.

— Pse, s'pranoni miq?.. Dera juaj për miq ka qenë gjithmonë e hapur!.. Babai juaj, ndjesë pastë...

— Ju lutem, babanë tim e lini të tretet rehat aty ku ka rënë. Më thoni, ç'doni nga unë!?

— Asgjë! Erdha vetëm që t'ju vizitoj! Miqtë e vjetër nuk harrohen kollaj «shoku Stefanaq» — tha i porsaardhuri krejt i qetë duke hequr kasketën nga koka.

— S'kam nevojë...

— Për çfarë?.. Për miq si unë? — e ndërpreu ai — Bah!.. Po më përzini?.. Shiko, shiko se sa larg paska shkuar puna!.. Domethënë s'më njihni për njeriun tuaj?..

— Ta thashë një herë!..

— Por të njohim ne, zoti Stefanaq! — ju përgjegj i xhindosur mysafiri që u ngrit me rrëmbim dhe ju afrua pranë. Nofullat e shtënguara dhe damarët që i kishin kërcyer nga inati, e tregonin edhe më të shëmtuar fytyrën e tij, që dukej sikur do ta përllante atë verdhacuk, që u zmbraps për t'u mbrojtur.

Në atë pozicion që kishin qëndruar, dukeshin si dy maçokë të tërbuar, që po bëheshin gati të mbysnin njëri-tjetrin, por zhurma e derës që u hap, i ndryshoi punët. Në hyrje u duk e zonja e shtëpisë. Ajo kishte veshur një penuar ngjyra-ngjyra dhe me tërë ato bigudina që kishte vënë në kokë, ngjiste si ndonjë dele laramane. Baluket e gjata i dukeshin si leshtë e deles me rodhe.

Ata të dy, porsa e panë gruan, menjëherë ndërruan pozicion, sikur të ishin dy aktorë me përvojë. Me një fjalë gruaja s'kuptoi asgjë ç'kishte ndodhur.

— Është një shok nga të punës — i tha Stefanaqi së shoqes duke i paraqitur mysafirin.

— Gëzohem, posi! Mirë mbrëma e mirë se na erdhe! — tha gruaja dhe i zgjati dorën të panjohurit.

— Mirë se ju gjeta! — u përgjigj ai.

— Si jeni me shëndet? Të gjithë të afërmit mirë?...

— Ju faleminderit, po ju?..



— Mersi! Mersi — tha ajo në gjuhën franceze, sikur ta dinte në majë të gishtave atë gjuhë, kurse në të vërtetë s'dinte asnjë fjalë më tepër nga ajo «mersi». Ajo e shqiptoi atë fjalë me delikatesë, se dera e tyre e kishte patur zakon ta përdorte si «familje me kulturë», që hiqeshin.

— Po uluni! Uluni! Pse rrini në këmbë, Fankë! Uluni!.. Ja, sakaq, do t'ju gostis — tha ajo dhe shkoi te rafti ku mori një shishe me raki rrushi dhe dy gota.

— Mos u mundoni, ju lutem, është e tepërt — tha mysafiri.

— Bah, ç'është ajo! — u përgjigj gruaja dhe gotat e mbushura me raki i vendosi mbi tavolinë para dy burrave, që zunë vend në kolltukët ngjyrë kafe në të errët.

— Lere dhe shishen — i tha i shoqi.

— Po mirë, si të kini qejf. Ju bëni muhabet, kurse mua do të më falni, se po merrem me përgatitjet për ditëlindjen e Fankës, që e kam mbas disa ditësh — përfundoi gruaja.

— Shiko punën! Shiko punën — ja priti mysafiri dhe ajo doli nga dhoma duke përdredhur pak belin. Mbas një heshtjeje të shkurtër, Stefanaqi mori në dorë gotën e rakisë. Atë bëri dhe tjetri.

— Gëzuar! — tha mysafiri.

— Gëzuar!

— Tani m'u duke Stefanaqi i vërtetë!

— S'kam ndryshuar! Jam ai që kam qenë — u përgjegj burri me bizhama duke shtrembëruar buzët nga kupa me raki që ktheu menjëherë.

— Kurse unë, të them të drejtën, po shoh se ke ndryshuar. E po ç'të bësh! Ndryshon koha, ndry-

shojnë dhe njerëzit. Tani që erdha rrugës, as nishan nuk i pashë dyqanit tuaj!.. Bukur! Bukur shumë!.. Aty paskan ndërtuar një pallat të madh!..

Këto fjalë të zotit e shtëpisë e ngacmonin si zjarri ujët në kazan, prandaj edhe ai zjente përbrenda por nuk u përgjegj.

— ... Po s'prish punë!.. — vijoi mysafiri — ti Stefanaq prapë qenke mirë. Punë të kanë dhënë.: Pse të mos bëhesh me ta?!..

— Unë të bëhem me këta? Kurrën e kurrës — shfryu me inat tullaci, që ishte bërë më i verdhë seç ishte.

Mysafiri qëllimisht e thumbonte me ato fjalë. Ca vetë e ca nëpërmjet të të tjerëve, ai e njihte me dhëmbë e dhëmballë Stefanaq Kurrizin. Familja e tyre kishte qenë familje tregëtarësh den-babaden!.. I jati, Postol Kurrizi, nuk kishte patur ndonjë pasuri të madhe, por ishte lidhur aq shumë pas parasë dhe pasurisë sa që, kur i mbyllën dyqanin, ra i sëmurë e nuk e ngriti më kokën gjersa vdiq, S'do mend dhe i biri s'binte poshtë. Megjithëse kishte qejf, ai nuk pati mundësi të merrej gjatë me tregëti, por xhambasllëqet që i la trashëgim i jati, dinte t'i përdorte me mjeshtëri. Mirëpo, këto xhambasllëqe e futën dhe në telashe nga të cilat tani nuk dilte dot. Ato dhe urrejtja për pushtetin, e bënë agjent të spiunazhit të huaj. Kur mendonte se që i tillë, i vinte mirë, se kështu do ta shfrynte dufin mbi këta që «e kishin katandisur punëtor krahu» aty në sektorin e ngarkim-shkarkimit të ndërmarrjes. Por nganjëherë kjo dhe e tmerronte!

Ishte finok i madh prandaj urrejtjen e punën e tij armiqësore e fshihte me kujdes, ashtu siç fsheh

gjarpëri këmbët. Hiqej sikur nuk çante fare këmbën për mallin e dyqanin që i kishin prishur t'et. Aktivist si asnjë tjetër... Ishte i gatshëm kurdoherë për të kryer çdo detyrë që i ngarkohej në lagje ose në ndërmarrje. Mirëpo ky qingj në pamje nuk prishte veçse rastin që të tregonte dhëmbët e tij prej ujku. Ja, këto ishin arësytet që e tha me aq urrejtje atë: «kurrë!»

— Kur është kështu, ahere si e shpjegoni qëndrimin tuaj, zoti Stefanaq? — tha mysafiri që nuk po e linte të qetë por po e ngacmonte vazhdimisht me pyetje provokojëse — Apo kini frikë?

— Po, edhe frikë kam! Këtu të mbysin edhe fëmijët.

Si njeri i regjur në këto punë, i porsaardhuri e kuptoi pse e priti aq pa dëshirë ardhjen e tij i zoti i shtëpisë. Ai e dinte se vërtet Stefanaq Kurrizi ishte bërë agjent i tyre, por gjer ahere kishte punuar shumë nënë rrogëz dhe nuk ishte ngarkuar të bashkëpunonte me agjentët e ardhur nga jashtë shtetit. Kështu do të donte Stefanaqi, të vazhdonte përherë kjo punë, por ja që i erdhi radha të punonte edhe ndryshe.

Prandaj mysafiri qeshi me ironi kur dëgjoi fjalët: «Këtu të mbysin dhe fëmijët!»

— Mos kini frikë! Nuk janë dhe aq të rrezikshëm sa mendoni ju! Po të ishte kështu, ne sonte nuk do të qemë në këtë dhomë të pinim raki njëzet e katër gradëshe — tha duke qeshur prapë me ironi e mburrje mysafiri — Prandaj duhet kurajo. «Drejtori i ndërmarrjes» ka besim se ne do t'i kryejmë detyrat!

I zoti i shtëpisë zgurdulloi sytë. «Aha! Më er-

dhi fundi» mendoj ai me vete. Të kundërshtonte s'mundej. Ata e kishin në dorë. U mat diçka të thoshte por tjetri ja preu fjalën për gjysmë:

— Çdo gjë është e formës së prerë. Ky është urdhëri i «Drejtorit» dhe ne do të dimë t'i kryejmë detyrat që na ka besuar — tha ai dhe gotën me raki, që kishte në dorë, e përplasi me gotën e Stefanaqit, që dëgjonte si i shastisur.

— Hajt, gëzuar! Për fitoren tonë! — vijoi ai, që, duke dashur t'i jepte kurajo, përfundoi: — Ne do të dimë të hedhim gurin dhe të fshehim dorën!

\* \* \*

— Gjurmët këtu vërtet janë zhdukur — tha ushtari që shoqëronte qenin e kufirit.

— Sado që të fshihen, prapë këtu do të kalojnë, se kanë hesape për të larë — ja priti një fshatar i moshuar duke treguar grykën e belxhikut që mbante në dorë. Të gjithë ja shkrepën të qeshurit. Qeshën me shpirt megjithëse ishin të lodhur. Kishin mjaft orë që s'po u zinte këmba dhe. Grupi i ngarkuar me ndjekjen e diversantit, që tani ndodhej aty te rruga automobilistike, e pati mjaft vështirë.

Nga dredhitë që kishte përdorur shkelësi i kufirit për të hyrë në thellësi të territorit, ndjekësit e kuptuan se në atë gjurmim kishin të bënin me një agjent të regjur. Shpesh ai kishte dredhuar si lepuri, por ata i zbuluan gjurmët e tij, dhe e ndoqën këmba-këmbës deri sa arritën aty te

rruga automobilistike. Këtu i pari ndali qeni e pastaj me radhë pjesëtarët e njësitit. Më mbrapa se të gjithë erdhi ai më plaku, njëri nga fshatarët, që bënte pjesë në njësitin vullnetar të ndjekjes.

— Pse qëndruat? — pyeti ai.

— Janë zhdukur gjurmët — ju përgjegj një kufitar.

— Ta hajë dreqi! O burrani t'i kërkojmë! Hajdeni, djema, ç'më rrini akoma? — tha plaku dhe të gjithë u bënë gati, por i ndali oficeri: — Është e kotë, shokë! S'kemi ku t'i gjejmë gjurmët e shkelësit. Si duket, që këtu ai duhet të jetë larguar me ndonjë automjet!

Nga ç'drejtim i rrugës automobilistike ishte larguar shkelësi i kufirit?..

Ja, kjo, vetëm kjo i shqetësonte pjesëtarët e njësitit ndjekës më shumë se lodhja.

\* \* \*

Stefanaq Kurrrizin e shqetësonte diçka tjetër. E shqetësonte halli i detyrave që i ishin ngarkuar dhe mbi të gjitha, frika. Qysh prej asaj nate që në shtëpinë e tij kishte ardhur ai mysafir i paftuar, i dukej sikur frika e ndiqte hap mbas hapi. Ishte bërë nervoz sa që nganjëherë desh të flakte çdo gjë e të rrinte i qetë në shtëpinë e tij, por urdhëri i «Drejtorit të ndërmarrjes» ishte i prerë e ai s'mund të bënte ndryshe.

Atë mbrëmje, si doli nga puna, nuk shkoi drejt e në shtëpi, siç e kishte zakon, por u kthye në një

kafe-pijetore, që ishte aty pranë agjensisë së pasagjerëve. Zuri vend në një karrige pranë tavolinës ku ishin ulur dy shoferë dhe porositi një kafe, të cilën kamarierja nuk ja vonoi. Klubi ziente si zgjua bletësh nga bisedat e klientëve, ndërsa ai po pinte kafënë i heshtur e kokulur, sikur t'i ishin mbytur gjemitë.

— Ej! Këtu qenke ti, ore?! Hajde na gostit, se sot shpëtove mirë — i tha një burrë me mustaqe spic që i erdhi pranë. E njohu menjëherë: Ishte shoferi që në mëngjezin e asaj dite, për pak sa nuk e kishte shtypur me maqinë. «Skoda» e tij kishte bërë mbrapsht për t'u afruar në vendin e shkarkimit, kurse Stefanaq Kurrizi, me lopatë në dorë, rrinte ulur si ndonjë mumje e pinte duhan. Vetëm britmat e punëtorëve që i kishin thërritur të frenonte, e kishin sjellë në vete dhe e kishin bërë të largohet, se përndryshe do të ishte bërë petë!

Ja, për këtë arsye shoferi me mustaqe spic i kishte thënë: «gostitmë!»

— Epo, mendje është — u justifikua Stefanaqi.

— Mendje, mendje, por nga ajo mendja jote, unë mund ta pësoja siç e pësoi Rakip Bushi, që e ngjeshën brenda — tha shoferi si zuri vend në karrigen bosh pranë dy shoferëve të tjerë.

— Mo po atij mirë ja bënë. Më thanë se kishite pirë e prandaj u përmbys — tha ai që deri atëherë s'kishte marrë pjesë në bisedë.

— Pasagjeri që kishte në taksi më thanë se vdiq në spital — vijoi tjetri. — Kështu u hap kjo çështja e aksidentit automobilistik të Rakip Bushit. Stefanaqi hiqej sikur nuk i interesonte fare ky

muhabet, por në fakt veshët i mbante ngritur si të lepurit. Sa herë që rastiste të dëgjonte biseda të tilla, ku bëhej fjalë për këtë çështje, mendohej të mos i shpëtonte asgjë, përgjonte se mos mësonte ndonjë të re më shumë nga ato që dinte.


Siç flitej, aksidenti automobilistik, që kishte ndodhur aty ca kohë më parë, ishte bërë shkak që organet e drejtësisë të arrestonin Rakip Bushin. Thoshin se ky i fundit kishte rënë në hall. Mirëpo ja që ajo ngjarje na kishte tronditur jo më pak dhe Stefanaq Kurrrizin. Kaq shumë e kishte shqetësuar sa, kur e kishte mësuar për herë të parë, netë me radhë s'kishte vënë gjumë në sy. Më vonë sikur e kishte mbledhur veten, por prapë i prishej gjaku kur dëgjonte të flitej për atë aksident, kur kujton-te Rakip Bushin!..

— Si burrë i mirë e hiqte veten — tha një nga shoferët në vazhdim të bisedës që ishte hapur.

«Dreqi e njeh atë njeri» — u përgjigj me vete Stefanaqi, që mblodhi supet sikur të kishte të ftohtë dhe padashur solli ndër mend ato që dinte për jetën e Rakip Bushit:

«...Çapkën e harrakat i madh kishte qenë ai në vogëli. Si djalë i vetëm pasaniku, nuk respektonte as të jatin, Dalip bejnë, e jo më të tjerët. Kur arriti në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, i hazdisur nga të mirat, ja mbathi jashtë shtetit që «të bënte qejf». Mbas kësaj, me vdekjen e të jatit dhe të së jëmës, pasuria e tij u bë rrush e kumbulla, se mbeti në duar të botës. U bë kështu, se edhe trashëgimtari i vetëm i familjes së Bushillarëve, humbi pa nam e pa nishan!..»

Këto mbante mend Stefanaqi për Rakip Bu-



shin sa ishte i vogël, kurse vitet e tij jashtë shtetit, për atë dhe shumë të tjerë mbeteshin enigmë e vërtetë. Për ato vite, të dhëna të sakta kishin vetëm ata që e ndiqnin hap mbas hapi aktivitetin e tij. Punonjësit e degës së punëve të brendshme, në zyrën e të cilëve disa muaj më parë ishte zhvilluar kjo bisedë:

«—... S'ka lënë vend pa bredhur! Në Itali, në Francë, në Angli, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tani së fundi në Gjermaninë Perëndimore. Këtu ka kryer dhe kursin e fundit të «specializimit» — tha shefi i degës.

— Po këtë shenjë plage? — pyeti punëtori operativ duke vërejtur me kujdes fotografinë që mori në dorë.

— E ka marrë në një përlëshje që desh e pagoi me kokë. Ka qenë «specialist», pjesëmarrës aktiv në bandat e gangsterëve që merrreshin me vjedhje — u pëgjegj oficeri i moshuar.»...

Të gjithë për shofer e njihnin Rakip Bushin. Përse e mësoi këtë profesion me nxitim dhe si u riatdhesua, pse plasi gjersa siguroi një punë të tillë? Këtë e dinin më mirë ata në perëndim që i kishin thënë:

«... Si shofer taksie do të kesh mundësi të lëvizësh lirisht për të organizuar rrjetin e ndërlikues sonë, që na është paralizuar, prandaj duhet të bëhesh «shofer i klasit të parë»...»

Rakipi e plotësoi me zell të madh këtë porosi. Brenda një kohe të shkurtër, mbasi siguroi taksinë, trokiti nëpër dyert e atyre që ishin struktur si minjtë, vendosi lidhje ndërmjet tyre dhe shefit të tij jashtë shtetit. Bile shkoi edhe më larg: Duke u ma-



rrë njëkohësisht dhe me kontrabandë, se s'mund të hiqte dorë prej saj, hodhi në kurth dhe Stefanaq Kurrizin. Me një fjalë, kishte leverdi, prandaj punonte pa u lodhur!..

— Për të punuar punonte; edhe si shofer ishte i mirë — tha ai me mustaqe spic.

Stefanaqi, tani dëgjonte me vëmendje bisedën e shoferëve. Ai merrej me ato që i kapte veshi. Kështu ndodhi edhe kur dëgjoi atë që tha: «Për të punuar punonte; edhe si shofer ishte i mirë».

«Ç'djall i mirë! Po të ishte shofer i mirë, nuk e bënte atë aksident që bëri. Ah, kur nuk hëngri dhe kokën e tij, rrufjani, që të kisha shpëtuar unë! — mendoi verdhacuku, i cili mblodhi supet sikur t'i kishte hedhur njeri ujë në kurriz, dhe vijoi të qante hall me veten e vet: «Sa frikë kam që e arrestuan! Sa frikë kam se mos tregojë gjë për mua dhe më merr më qafë! Po dale, ç'them kështu? — arësyetoi ai — Rakipi nuk është aq budalla sa të tregojë se më ka rekrutuar agjent të spiunazhit të huaj! Po ta bëjë këtë, duhet të japë llogari dhe për veten e vet!.. Kështu duhet të jetë! Kështu, po mua s'po më fle mendja!.. Jo, jo! S'ka arësye përse të kem frikë! Nga këto që thuhën, duket se ai është arrestuar vetëm për aksidentin automobilistik e ndoshta për këtë dhe do të dënohet!.. More në djall të vejë! Ishalla është kështu që të shpëtoj unë për veten time!.. Kështu duhet të jetë për deri sa thonë të gjithë!..»

Këto mendime, që i rrodhën shpejt e shpejt, dhe gjithë informatat që kishte mbledhur për këtë çështje, sikur ja larguan frikën Stefanaqit, prandaj

ai, si pagoi kafënë dhe si u tha «natën e mirë» shoferëve, doli nga lokali i përtëritur.

Jashtë ishin ndezur dritat dhe po binte një shi i hollë. Ai ngriti jakën e xhaketës dhe u nis për në shtëpi. Pa dalë mirë nga rrugica që shpinte te kryqëzimi i rrugëve, dikush që doli sikur mbiu nga dheu, e kapi për krahu «angazhe» dhe e futi nën ombrellën e tij, që e mbante pak të pjerrët përpara.

Stefanaqi u hutua fare. Kush dreqin ishte ai njeri që i doli si ndonjë fantazmë?..

— Mos u shqetëso! Jam unë — tha me zë të ulët i panjohuri, i cili kuptoi jo vetëm shqetësimin, por ndjeu dhe dridhjen e lehtë të atij trupi të paktë. E njohu nga zëri. Ishte «Kobra»! Kështu e kishte pseudonimin agjenti i ardhur nga jashtë shtetit, një kriminel nga krahinat e Jugut, i arratisur fill mbas çlirimit e që disa net të shkuara Stefanaq Kurritit, i kishte zënë derën si mysafir i paftuar.

Takimi për tullacin ishte fare i papritur. U bënë tri ditë që ishin ndarë nga njëri-tjetri e nuk e dinin se kur do të takoheshin, mbasi «Kobra» nuk i kishte lënë datë e vend takimi. Mirë thonë: «Spiuni nuk i beson as lëkurës së tij»!

Të dy nxitonin. Biseda e tyre me zë të ulët, ishte e zakonshme, e shkurtër dhe e prerë:

— Ç'more vesh për të sëmurin? — pyeti «Kobra».

— S'ka rrezik! Nuk është sëmundje ngjitëse — i pëshpëriti Stefanaqi.

— Ashtu qoftë — tha «Kobra», që i lëshoi krahun dhe u përgatit të largohej.

— Urdhëro për darkë — e ftoi tjetri.

— Të falem nderit, do të vij tjetër herë.

— Të urdhërosh — ju përgjigj shkurtabiqi tullac dhe të dy u ndanë në drejtime të ndryshme, bile pa i thënë as «natën e mirë» njëri-tjetrit. Kushdo që do ta kishte dëgjuar bisedën e tyre, as që kishte për të dyshuar. Në të vërtetë ajo bisedë ishte plot nëntekst dhe kishte të bënte me detyrat kryesore të të dy agjentëve, të cilët ishin të bindur se i kuptonin vetëm ata.

\* \* \*

Mbasi mori njoftim se Kufiri shtetëror ishte shkëlur dhe se shkelësi kishte mundur të hynte në thellësi të tokës sonë, shefi i degës së punëve të brendëshme e dëgjoji me vemendje punëtorin operativ, që i raportoi:

— ...Shtëpia e shtatëmbëdhjetës u vizitua nga një person i panjohur dhe i dyshimtë. Vetë shtatëmbëdhjeta ka filluar të lëvizë...»

— Shumë mirë! Domethënë se ne nuk kemi gabuar në llogaritë tona. Me një fjalë peshqit po i afrohen «pezaulit», shoku Dhori.

Oficeri tjetër pohoi me kokë.

— Kur është kështu, nuk do të ishte keq që, me kujdes, të loznim pak me ta si «macja me miun» vijo ai.

— Nuk do të ishte keq — ju përgjigj Dhori me të qeshur, se e kuptoi ironinë e tij.

— «Loja» pra, do të zhvillohet ashtu siç e kemi parashikuar. Rezultatet e saj të para nuk janë të këqia — tha oficeri flokëbardhë, që thithi cigaren i kënaqur.

Edhe «Kobra» ishte mjaft i kënaqur nga rezultatet e arritura në aktivitetin e tij. Në të vërtetë, nuk e pati dhe aq të lehtë sa ja paraqitën ata që e dërguan, por prapëseprapë ja doli mbanë. Këtë e shpjegonte me aftësinë e tij që dinte «t'ua hidhte të kuqve» aq bukur duke vepruar mu para hundës së tyre. Kur të kthehej atje nga kishte ardhur, do të kishte çfarë t'i raportonte eprorit që e priste, kolonelit Joanidhis, që për atë tani quhej «Drejtori i ndërmarrjes». Pastaj e prisnin dollarët, femrat, kabaretë!.. Këto ishin qëllimet e jetës së tij. Për t'i realizuar ato, ishte gati të kryente dhe krimin më të shëmtuar. Nuk ja kishin ngjitur kot së koti pseudonimin «Kobra»!.. Ai pseudonim për të ishte kuptimplotë!

Menjëherë, mbasi u nda me Stefanaq Kurrizin, «Kobra» zbërtheu me mend kuptimin e bisedës që pati pak më parë:

«... S'ka rrezik! Nuk është sëmundje ngjitëse» do të thosh: Rakip Bushin e kanë arrestuar për aksidentin automobilistik dhe jo si agjent të spiunazhit të huaj. Pra, s'ka rrezik të na kenë zbuluar!

«Mrekulli — tha «Kobra» me vete. Kjo ishte detyra e parë që i qe ngarkuar: «Të mësonte shkakun e vërtetë të arrestimit të agjentit Rakip Bushi, i cili kryente ndërlidhjen e spiunazhit, që për çdo rast, të merreshin masat e nevojshme për të mbrojtur agjentët e tjerë. Me të dhënat e mbledhura, «Kobra», këtë detyrë e konsideroi të kryer. I mbe tej detyra tjetër!..

Kjo i përkiste Stefanaq Kurrizit. Ai do ta

shtronte «darkën» për të cilën po përgatiteshin me kujdes.

Ç'ishte kjo darkë që përgatitej?..

Nënoficeri aktiv i këmbësorisë, Servet Lashi, që shërbente si kujdestar kompanie në një repart pranë komandës së garnizonit, banonte përballë me shtëpinë e Stefanaq Kurrizit. Me këtë njeri tullaci e kishte trashur miqësinë kohët e fundit.

«... S'ka si burri yt — i thoshte Stefanaqi së shoqes së Servetit — Më pëlqen! Është djalë serioz, i dashur!.. Nuk i bie tjetrit më qafë. Ja, kemi katër-pesë vjet që banojmë pothuajse në një shtëpi, se një rrugicë na ndan de, e nuk kemi këmbyer dy fjalë. Për besë, për njerëz të tillë unë jap dhe kokën!..»

«... Hiç mos të të vijë rëndë! Ç'është ajo! Për çdo gjë që të kesh nevojë, të vish si në shtëpinë tënde. Ç'të kem, merre e ma kthe kur të të vijë për mbarë — i thoshte Servetit.

Kështu shtuan jo vetëm miqësinë e muhabetin, por edhe hyrjet e daljet nëpër shtëpitë e tyre. Stefanaqi shpeshherë i qante hallin se ai kishte detyrë me rëndësi, se lodhej nga shërbimet e shumta. E këshillonte si «prind» të kishte kujdes, e të tjera.

Hë! Ta dëgjonte njeriu kur i fliste ashtu, vinte dorën në zjarr, se me gjithë mend i «kishte hyrë në zemër» dhe e donte për gamet.

Stefanaq Kurrizin, nuk e shikoje kurrë të shoqërohej me njerëz që kishin «kleçka». Jo!... Ishte finok ai, dinte me cilët duhej të shoqërohej. Shoqëria me të parët mund t'i nxirrte telashe, kurse shoqëria me të dytët, do ta tregonte njeri të ndershëm e të lidhur me pushtetin. Nga këto qëllime u nis ai herën e parë kur lidhi shoqëri me Servetin po kur

rekrutua dhe ju ngarkuan detyra nga Rakip Bushi, punët ndryshuan. Megjithatë, Stefanaqi, si dhe më parë, vazhdonte «ta kishte në zemër» dhe «ta donte si djalin e tij». Më vonë me marifet i vodhi ca të dhëna që përbënin sekret ushtarak si dhe disa rregullore për përdorim të brendshëm.

Prandaj mendonte se e kishte shtënë në dorë, por prapë nuk e merrte vesh përse Rakip Bushi ishte kënaqur me aq. Vetëm tani që erdhi «Kobra» u morën masat që të shijoheshin frutet e asaj pune të gjatë e të kujdesshme të Stefanaqit.

— Si duket? — e pyeti «Kobra» Stefanaqin, kur pregatisnin planin që Servetin ta shtinin në rrjetin e tyre.

— Sylesh është! Do të dorëzohet shpejt, e njoh mirë — ju përgjegj ai.

Se sa e rrezikshme ishte pakujdesia, nënoficeri e provoi në mbrëmjen e «ditëlindjes së Fankës», ku e ftuan për vizitë.

...Në çastin e përshtatshëm, Stefanaqi i propozoi detyrën që duhej të kryente, mirëpo ai jo vetëm që nuk pranoi, por u ngrit si i tërbuar dhe ju hodh në grykë shkurtabiqit, që përpëlitej t'i shpëtonte nga duart, duke i thënë:

— Do të bësh si të them, se të kam paguar!..

— Pse, për këto punë m'i ke dhënë paratë, more edepsëz — i shfryu ushtaraku, që e shtrëngoi edhe më fort, saqë Stefanaqi i perëndoi sytë. Gjendja u acarua tepër e po zhvillohej ashtu siç nuk prisnin organizatorët e saj. Nga kjo ngjarje mund të përmbyseshin të gjitha planet, prandaj duhej vepruar pa humbur kohë. Pikërisht në çastin më kritik, u hapën kanatat e dollapit të madh dhe që andej, me thikë e revolver në dorë, doli «Kobra».

— Më falni që ju prisha qetësinë, por nuk mund të rri mënjanë kur dy vetë kacafyten me njëri — tjetrin. Pse kështu?! Pse kështu?!... S'ka lezet! — tha ai duke lëvizur me nervozizëm thikën që kishte në dorë.

— I kam dhënë para hua dhe e bën hasha — u përgjigj Stefanaqi, që mezi mbushej me frymë.

— Nuk e bëj hasha se të kam marrë para hua! Të kam marrë dhe do të t'i kthej ca e nga ca! Ç'kërkon tjetër nga unë? — tha Serveti, që mundohej ta përmbante tronditjen.

— Me sa kuptoj unë, tani për tani, shoku Stefanaq, nuk kërkon asgjë më shumë veçse t'i firmosësh një dëftesë për paratë që i ke marrë, se fjalët i merr era — ndërhyri «Kobra».

— Po, atë dua — tha Stefanaqi, i cili nxitoi t'i zgjaste nënoficerit një letër të shkrojtur dhe stilo-grafin. Ky i fundit e mori si me përtim dhe, si lexoi përmbajtjen e kësaj «dëftese», u zverdh edhe më shumë.

— Jo! Unë nuk kam marrë ndonjëherë para nga spiunazhi i huaj — kundërshtoi ai me zë të dredhur.

— Këtë s'mund ta mohosh! Urdhëro dokumentat që e vërtetojnë një gjë të tillë — e ndërpreu «Kobra» duke i lëshuar përpara disa fotografi, në të cilat ishin fiksuar momente kur Stefanaq Kurri-zi i jepte «para hua». Mbas kësaj atij i thanë se ato para i meritonte. Meritonte bile më shumë, mbasi rëndësi të madhe kishin patur edhe sekretet e marra prej tij, të cilat ja numëruan një e nga një.

«Bobo, unë i gjori, sa keq kam rënë! Me gjithë

këto nuk shpëtojnë dot nga këta maskarenj» — mendoi ai, që ishte hutuar aq shumë sa nuk e mori vesh fare kur vuri firmën mbi «dëftesë»!

— Mezi u muarët vesh më në fund. Edhe për pak ndonjëri nga ju, tani, do të ishte në botën tjetër — tha «Kobra» me një qeshje ironike, duke shikuar ushtarakun me bisht të syrit. — Kurse po të punojë logjika, është më mirë të jesh në këtë botë e t'ja shtrosh me raki — përfundoi ai duke qeshur dhe së bashku me të, me një zë të çjerrë si të kecit, qeshi dhe Stefanaqi, që akoma nuk e kishte marrë veten.

Mbas kësaj, dalëngadalë, gjendja u zbut. I zoti i shtëpisë, sa dëgjoi «Kobrën» të bënte fjalë për raki, shpejt e shpejt i mbushi gotat dhe muhabeti mori mbarë. Në këtë bisedë «miqësore», Servetit, që tani e quanin «të tyre», ja radhitën të gjitha të mirat dhe leverdinë që do të kishte nga ky bashkëpunim dhe të kundërtën po të vepronte ndryshe. Në bisedë e sipër «Kobra» i tha, në emër të shefit të tij, se së shpejti do ta shpërblenin me një shumë akoma më të majme. Këto bëheshin me qëllime të caktuara: «Ta bindnin përfundimisht se kishte vetëm një rrugë: T'u bindej urdhërave të tyre, se ndryshe do ta kishte shumë keq nga të dy anët!»

Si e pa se s'kishte nga t'ja mbante, Serveti pranoi të plotësonte detyrat e ngarkuara.

Si do t'i merrte të dhënat që i kërkoheshin? Këtë e dinte ai, që atë natë, si u nda prej tyre, nuk vuri gjumë në sy. Lëvizte e s'gjente rehat, sikur të ishte shtrirë mbi ndonjë dyshek me gjemba. U qetësua vetëm ahëre kur gjeti rrugën dhe vendosi se si do të vepronte për të plotësuar detyrën.



\* \* \*

Të nesërmen e asaj që ngjau në shtëpinë e Stefanaq Kurrizit, ashtu afër mbrëmjes, pa rënë në sy të askujt, nënoficeri u takua me shefin e degës së punëve të brendëshme të qytetit. Qysh në fillim ky i fundit e vuri re shqetësimin, prandaj e pyeti:

— Si i ke punët, shoku Servet? Më duket se je i shqetësuar.

— Unë kam bërë faje të rënda, shoku Skënder! Më dënoni! Më shpini në gjyq të më ndëshkojnë rëndë, se e meritoj — tha nënoficeri duke ulur kokën i pikëlluar.

— Prit ta marrim vesh. Si qëndron puna?! Ç'janë këto faje të rënda që ke bërë? — pyeti shefi, që u mvrejti në fytyrë. Tjetri i shpjegoi fill e për pe të gjitha ato që kishin ngjarë.

— Ja ç'do të thotë të shkelësh rregulloren që flet për ruajtjen e sekretit ushtarak! Ja se ku përfundon njeriu që nuk është vigjilent — tha oficeri duke psherëtitur i menduar.

— Po! Unë jam treguar sylesh. Ata më muarën tërë ato sekrete dhe më në fund më bënë agjentin e tyre! Më shpini në gjyq të më dënojnë se e meritoj — e ndërpreu Serveti që ishte bërë pikë e vrer dhe që priste nga bashkëfolësi një përgjegje të ashpër. Për çudinë e tij, shefi i degës veproi ndryshe. Ai i hodhi dorën në sup me përzemërsi dhe të dy përcaktuan detyrat e së ardhmes.

\* \* \*

Dita dhe vendi që nënoficeri do të dorëzonte informatat nuk ishin përcaktuar më saktësi. Për tri

ditë rresht, në mbrëmjet e datave 9 — 13 — 15 mbas orës 19, ai duhej të kalonte në një rrugicë që gjendej në periferi të qytetit. Aty do të bënte takim me «Kobrën», të cilit do t'i dorëzonte ato që i kërkoheshin. Dhe Serveti u tregua i përpiktë.

\* \* \*

Në atë rrugicë të ngushtë e të shtruar me kall-drëm, ishte pothuajse errësirë, mbasi llambat e ndriçimit qenë vendosur mjaft larg njëra nga tjetra. Lëvizjet e njerëzve në ato orë të vona ishin të pakta.

Silueta e një njeriu që kalonte tani në këtë rrugicë për të dytën herë, dukej e qetë. Ecte ngadalë. Në pamjen e jashtme të jepte përshtypjen se s'tregonte as interesin më të vogël për ata që kalonin. Por s'ishte ashtu! Zemra e tij rrihte fort. Çdo hije që i dilte përpara dhe i kalonte pranë, e vërente me kujdes të madh. Përshkoi kështu gjithë rrugën e caktuar; edhe pak e do të dilte jashtë qytetit, por nuk po dukej asgjë!..

«Ç'dreqin kanë! Prapë sonte si mbrëmë!» — mendoi ai.

Në këtë çast, jo shumë larg tij, vuri re një fshatar, që mundohej të ngrinte në kurriz një thes, po s'mundej. Disa herë e hodhi në shpinë e prapë i rrezohej. Fshatari nisi të shante thesin që ja solli në majë të hundës. Nënoficeri u afrua dhe u mat që ta ndihmonte, por shtangu: para tij kishte Stefanag Kurrizin.

— Hë, këtu, këtu — i tha Stefanaqi me zë të ulët dhe i tregoi një të çarë thesi, ku Serveti, me zemër të thyer, vendosi një pliko të mbështjellë me shami.

— Të faleminderit, shok! Natën e mirë — tha «fshatari», që me thes në shpinë shpejtoi hapat dhe u zhduk në errësirë!..

«Përse nuk erdhi vetë? — mendoi nënoficeri, që nuk lëvizi nga vendi. — Ai më tha se do të takohe-shim!»

\* \* \*

Dhe ata u takuan. U takuan të nesërmen në mëngjez, ashtu siç ishte parashikuar.

— Takim i bukur, apo jo, zotërinj? — tha oficeri flokëbardhë. Kishte të drejtë. Takimi qe vërtet një takim interesant. Në të merrnin pjesë pothuajse të gjitha personazhet që shtjelluan atë ngjarje...

Shefi i degës, gjithë qejf, kishte mbështetur bërrylat mbi tavolinën e punës dhe po thithte cigaren duke shikuar «mysafirët», që i kishin ardhur në zyrë. Në të majtë të tij, ndodhej Dhori, punëtori operativ. Përballë tyre, në një karrige, kokulur qëndronte «Kobra». Fytyra e tij e tregonte të dërmuar, ndërsa sytë e skuqur, gjysmë të hapur, e tregonin si ndonjë bishë të lidhur me pranga hekuri, që s'kishte mundësi të bënte as lëvizjen më të vogël për të shfryrë urrejtjen e thellë që e brente përbrenda. Pak më tutje, Stefanaq Kurrizi, i ulur në një karrige tjetër, ishte mbledhur si ndonjë kërmill.

— Pra, zotërinj, «loja» mori fund. Besoj se edhe ju do të jini të kënaqur që i plotësuat detyrat

— u tha shefi. Si nuk mori përgjegje prej tyre, shikoi kolegun që kishte në krah.

— S'ka arsye pse të mos jenë të kënaqur, shoku shef — ju përgjegj Dhori, të cilit i shkëlqente fytyra.

— Dikush më tha se zotërinjtë ishin shumë të shqetësuar për «gjendjen e të sëmurit» — vijoi shefi.

— Si urdhëron, ashtu — pohoi punëtori operativ.

— Kur është kështu, shoku Dhori, ndihmoi zotërinjtë që të mësojnë më me saktësi gjendjen e tij shëndetësore.

— Si urdhëron — tha oficeri dhe doli nga zyra. Mbas pak, së bashku me të hyri një burrë zeshkan e me trup të lidhur. Kishte veshur një xhaka-vento meshini ngjyrë kafe, qillota kadifeje dhe çizme të punuara për merak. Flokët e zez i binin mbi ballin e gjerë. Në faqen e majtë i dallohej shenja e një plage të vjetër. Së hyri, midis tij dhe atyre të dyve që ishin ulur pranë njëri-tjetrit, u zhvillua një dialog i heshtur:

«Rakip Bushi?!..» — thanë ata të dy.

«Kobra» këtu?! E pabesueshme» — mendoi Rakipi.

— E, zoti Rakip, si e ndjeni veten mbas «aksidentit automobilistik — e pyeti shefi.

— Unë s'kam bërë ndonjë aksident automobilistik. Pse më akuzoni kot dhe për këtë gjë? — u përgjegj Rakipi.

Të dy burrat e ulur lëvizin nga vendi, sikur t'i kishte shpuar ndokush me gjëlpërë që poshtë karriges.

«Ky më paska marrë më qafë» — mendoi Stefani, që u mblodh dhe më shumë si kërmill në guaskën e tij.

«Po! Gjithshka e qartë! Tani po e shikoj se arrestimin e Rakipit këta e kanë maskuar, që të na hedhin në kllapë. Bukur na e hodhën» mendoi «Kobra» duke ulur kokën i dërmuar. Ai vetëm tani e kuptoi se organet e sigurimit, Rakip Bushin e kishin arrestuar si agjent.

— S'kemi ç'bëjmë! Në «lojë» këto gjëra lejohen — u përgjegj shefi, që u duk sikur i dëgjoji mendimet e tyre. — Si e ndjeni veten, zoti «Kobra»?.. Po ju, zoti Stefanaq? — pyeti ai.

Ata heshtën.

— Kur u kap, u përpoq të zhdukte dokumentat — tha oficeri operativ duke treguar me dorë Stefanaqin.

— Ashtu?... A!.. Meqë erdhi fjala për dokumentat, le ta sqarojmë edhe këtë çështje — tha Skenderi, që shtypi një buton të vendosur në qoshen e djathtë të tavolinës. Nuk kaluan veç pak minuta dhe në zyrë hyri nënoficer Servet Lashi, që u paraqit ushtarakisht.

— Ju ua dhatë dokumentat? — e pyeti shefi.

— Si urdhëron — u përgjigj ai.

— Janë të dhëna të sigurta?

— Ju që i kini përpiluar, s'besoj se kini bërë ndonjë gabim — tha nënoficeri, që vuri buzën në gaz dhe rregulloi flokët me dorën e djathtë.

«Kobra» e Stefanaqi u prenë fare, kurse Serveti as që ua hodhi sytë atyre, të cilët, po të mos kishte vepruar si duhej në kohën e duhur, do ta kishin mbytur në llumin e ndyrë të tradhëtisë.

«Mbarova! Edhe ky maskara më paska marrë më qafë» tha me veten e tij Stefanaqi.

«Ja se çfarë «syleshi» qenka» — mendoi «Kobra» duke shikuar nënoficerin me urrejtje, sikur do ta hante të gjallë me gjithë rroba. Vështrimin e ktheu nga punëtori operativ e pastaj në fytyrën e qetë të shefit të degës. U tmerrua kur parafytyroi se si ra në duart e tij;

...I kishte premtuar Servetit që mbrëmjen e kaluar ta takonte vetë që t'i merrte të dhënat. Mirëpo që të mos rrezikonte lëkurën, ai dërgoi Stefanaqin. Duke dashur vetë që të ishte dëshmitar i takimit, të cilit i jepte rëndësi se aty do të provonte besnikërinë e Servetit, ai shkoi edhe vetë dhe qëndroi jo shumë larg vendit ku ata do të takoheshin, me qëllim që, po të ndodhte ndonjë e papritur, të mund të shpëtonte.

Si u largua «fshatari» me thes, edhe «Kobra» u nis të ikte, mirëpo kur po kalonte pranë një muri të rrëzuar, mbi të u vërvitën dy njerëz të fuqishëm që e shtrinë për tokë. U orvat të përdorte revolve-rin. Një goditje e saktë ja flaku tej si leckë. Mbas kësaj u mundua të kafshonte ampulën e helmit, që kishte vendosur në jakën e xhaketës, por ata me të cilët kishte të bënte, qenë më ustallarë!..

Ndërsa mendonte të gjitha këto, ju morën mendtë dhe kokën e mbështetur mbi pëllëmbët e duarve e shtërngoi fort. Tani vetja ju duk si ai gjarpëri që kishte parë të coptohej nga kthetrat e shqiponjës aty majë shkëmbit të thepisur.

## NË KËRKIM TË SE VËRTETËS

Një hije më e zezë se nata që kishte rënë, lëvizi rrëzë murit rrethojës të oborrit të ndërmarrjes, që ndodhej në periferi të qytetit. Hija ecte e ndalej, përgjonte me veshët ngritur. I dukej sikur do ta tradhëtonte edhe zhurma e lehtë e benzinës, e cila lëkundej në bidonin metalik që mbante në dorën e djathtë. I dukej sikur nga çasti në çast do ta kapnin. Por jo. Çdo gjë po i shkonte mirë, ashtu si atë mesnatë, muaj më parë, kur ju ngjit murit pranë ndërtesës, hypi në çati, hapi baxhanë, zbriti brenda në depo dhe me mjeshtëri vodhi ato që i kishte zënë syri duke mos lënë gjurmë dyshimi.

«Edhe kësaj here kështu do të kalojë! Hesapet i kam bërë siç duhet», mendoi duke shtërnguar bidonin metalik dhe pakon e mbështjellë me letër, që kishte në dorën e majtë. I shtërngonte në atë mënyrë sikur donte t'u thosh: «Tek ju i kam shpresat»!

I bindur për suksesin, ju afrua me kurajo depos. Në këtë kohë ndodhi diçka që nuk e priste. Në rrugicën aty pranë po kalonte dikush nga të ndërmarrjes.

«Ç'dreqin do ky njeri që doli këtu në këtë orë?

Punëtorët e turnit ka kohë që janë ndërruar! Mos është ndonjë që është vënë të ruajë depon fshehtas?» — pyeti me vete i llahtaritur.

Pa e zgjatur, me shpejtësi lëvizi dhe u mbështet pas murit që të mos diktohej, por këmba ju përpoq në një copë llamarinë të hedhur dhe shkaktoi zhurmë.

Si foli disa herë dhe nuk mori përgjigje, njeriu që kalonte u afrua të kontrollonte vendin. Në këtë mënyrë, ai do të kishte arritur ta zbulonte. Këtë gjë e pa të qartë «Hija» që ngadalë nxori një levë të cilën e kishte ngjeshur në rrypin e pantallonave. Atë e kishte marrë me vete për të hapur kapakun e baxhasë, por tani e rrëmbeu për tjetër punë. Si mbledhi tërë forcat, e qëlloi për vdekje në kokë personin që e rrezikonte dhe e rrëzoi si ndonjë trung të sharruar duke e lënë pa ndjenja.

Nga kjo ngjarje e rrezikshme, që nuk e dëshironte u hutua shumë. U hutua aq shumë sa dhe pak desh flaku çdo gjë që kishte me vete, vetëm që të largohej sa më parë, por shpejt e mbledhi veten. Rrëmbeu bidonin me nxitim dhe humbi në errësirë!

\* \* \*

— Plagë e rëndë... Ai ndodhet në rrezik!.. Shkaku?.. he për he mbetet i panjohur... — Si shqiptoi nëpër dhëmbë këto fjalë të shkëputura nga materiali që kishte përpara, Hiqmeti mbështeti kokën mbi pëllëmbën e dorës dhe qëndroi ashtu duke shikuar gërmat e renditura mbi letër. Nga puna e gjatë, sytë i ndjente të lodhur, aq sa ato



gërma i shëmbëllenin si shiritë të dhëmbëzuar që nxinin mbi letrën e bardhë. Megjithatë, vemen-djen e kishte përqëndruar në atë çështje që atij i ngjiste si ndonjë lëmsh i madh, ku ishin ngatërruar fije të shumta, të cilave s'dinte nga t'ua kapte fillin.

— Sidoqoftë, ky lëmsh duhet zgjidhur — tha ai dhe mori lapsin në dorë. Po si? Nga duhej filluar? Kjo nuk ishte e lehtë. Të dhënat ishin aq të pakta sa që e shikonte veten të zënë ngushtë.

«A do të mundem ta zgjidh?»

«E pse jo! Në shkollë kam qenë nxënës i mirë!»

«Po sa para bën kjo, në qoftë se në praktikë nuk i zgjidh problemet!»

Në këto mendime e sipër, ju kujtua biseda që kishte patur me shefin e tij ditën kur i kishte ngarkuar detyrën që kishte përpara.

Pasi i kishte shpjeguar ndodhitë dhe i kishte dorëzuar materialin përkatës, shefi i kishte shtërnguar dorën dhe i kishte uruar sukses oficerit të ri duke e këshilluar: «Në fillim do ta kesh vështirë, por do të mësohesh. Edhe ne s'kemi qenë të mësuar. Bile pa shkollë e pa praktikë. Kurse ju kini shkollën, teorinë. Praktika fitohet në punë, në jetë. Kjo do t'ju bëjë që të ecni me këmbët tuaja. Me një fjalë, njeriu duhet të hidhet në ujë që të mësojë notin!..»

Oficeri e kishte vështruar shefin dhe kishte ndjerë kënaqësi. Ato këshilla i jepnin zemër. E s'lli nëpër mend njeriun që kishte kryer krimin e shëmtuar dhe ju duk sikur ndeshej me të dhëmbë për dhëmbë, por fytyrën nuk ja përfytyronte dot.

Prapë ju bë sikur dëgjoi zërin e shefit tek i fliste:

«Veç ne, punonjësit e organeve të punëve të brendshme, duhet të jemi notarë të përsosur. Ne duhet të jemi të atillë që t'u bëjmë ballë detyrave të vështira, si zgalemët furtunës në det.»

Kishin kaluar më se dyzet orë që nga ajo bisedë e tashti, ngaqë nuk kishte arritur rezultatet e dëshiruara, po i vinte të pëlçiste nga inati. Kjo e bëri oficerin e ri që t'i lindnin fije dyshimi për pafatësinë e tij. Po kur mendonte kështu, solli në kujtesë fjalët: «Noti mësohet duke notuar!..»

«Do ta provoj ndryshe më mirë» — tha ai me vendosmëri dhe prapë shfletoi dokumentat e vendosura në dosjen përkatëse. Pra, ja dhe uji. Por për atë kishte aq shumë, saqë i dukej se do të notonte në një det të gjerë, ku nuk shikonte gjë tjetër veç ujit dhe kupës së qiellit që bashkoheshin në vijën e horizontit.

«Si duhet të dal në breg?» — pyeti ai vetëveten.

Ndërkohë ju bë sikur dokumenti që kishte përpara, u mbush me pikëpyetje. Ashtu instiktivisht me lapës ai shënoi një pikëpyetje të madhe dhe pastaj u ngrit në këmbë.

«Po — tha duke përplasur dorën e djathtë mbi dosje — Kjo kërkon zgjidhje! Dhe unë do të mundohem ta zgjidh!

I ishte mbushur mendja top se vetëm deponimet e të plagosurit do t'i jepnin çelësin për të zbuluar të vërtetën. Kjo ishte arsyeja që ditën e nesërme e priste me padurim. Mjeku i kishte premtuar se do ta lejonte të bisedonte me të.

— ... Atë natë isha turni i dytë. Më ndodhi një difekt në maqinë dhe për këtë dola më vonë se sho-kët nga puna. Për të fituar kohë, nuk kalova nga rruga e zakonshme, por nga një rrugicë që i binte më shkurt për në rrugën kryesore. Kur arrita te kthesa, pashë se rrëzë murit të depos lëvizi me të shpejtë dhe u zhduk një «hije e zezë» e dyshimtë. Sa e pashë, ndala në vend dhe thërrita: «Kush je ti?» Nuk m'u përgjegj njeri. Si prita pak, thërrita dhe një herë. Përsëri nuk mora përgjigje. Vetëm dëgjova një zhurmë llamarine, prandaj u nisa drejt saj. Ishte errësirë e plotë dhe nuk shikoja gjë, por unë vazhdova të kërkoj, mbasi isha i bindur se ajo «hije e zezë», duhej të ishte aty dhe s'kishte mundësi të qe larguar pa e vënë re. Nuk arrita të ktheja kokën mbrapa, për të parë se çfarë e shkaktoi atë zhurmë të mbytur që më zuri veshi, se në kokë ndjeva një dhëmbje të madhe! Se çfarë ndodhi me mua më vonë, asgjë s'më kujtohet!..

I plagosuri po fliste gjithnjë e më me ngadalë, aq sa më në fund mezi u dëgjua. Si mbaroi fjalën e fundit, ai mbylli sytë për disa çaste, pastaj i hapi përsëri dhe shikoi oficerin me dashuri, duke dashur t'i buzëqeshë, por me zor...

«E qartë» mendoi Hiqmeti «Të folurit e dëmton dhe i shkaktton dhëmbje. S'duhet që ta zgjas më. — «Por akoma nuk kishte marrë ato që i nevojiteshin, prandaj, megjithëse i erdhi keq, e pyeti përsëri:

— Kaq?..

I plagosuri pohoi me kokë duke mbyllur sytë i

lodhur. Oficeri priti dhe pak ashtu në heshtje, pastaj u largua në majë të gishtave pa bërë zhurmë. Kaloi nëpër korridor, zbriti shkallët e spitalit dhe doli jashtë. Rruga ziente nga zhurma e kalimtarëve dhe e maqinave. Të gjitha këto s'kishin se si të mos tërhiqnin vëmendjen e njeriut, por atij asgjë s'po i bënte përshtypje. Deponimet e të plagosurit i ishin ngulitur në mendje dhe, duke ecur, mundohesh të përfytyronte atë ngjarje sipas atij tregimi nga i cili nxuarën kokë telashe të tjera.

«Kush ishte ajo «hije e zezë»? Pse e goditit punëtorin?»

Materialet e sigurta që kishte mbledhur, tregonin se kishte shumë mundësi që kjo «hije e zezë», ta kishte goditur punëtorin, jo për grindje personale, por për arësye të tjera.

Cilat ishin këto arësye?

Me këto mendime erdhi në zyrë dhe menjëherë u zhyt në materialin e ngjarjes. Tani po bindej se çështja nuk ishte aq e thjeshtë sa e kishte menduar më parë. Deponimet e të plagosurit i dhanë një pasqyrë të ngjarjes, por i nxorën dhe bishta që e koklavisnin më shumë çështjen. Kaq i përqëndruar ishte në këto mendime sa nuk mori vesh fare se dera ishte hapur dhe pranë i kishte ardhur shefi, i cili qëndronte në këmbë duke e shikuar i heshtur e buzëgaz.

— E? Ç'thotë puna? — e pyeti ai dhe u ul në një karrige që ishte vendosur pranë tavolinës së punës.

— Si t'ju them....— u përgjigj Hiqmeti. Ai bëri një gjest që tregonte se nuk ishte i kënaqur nga puna që kishte bërë. Shefi, që e kuptoi se ç'desh të thoshte me këtë, ja priti:

— Domethënë ti s'je i kënaqur nga puna jote? Ja të shikojmë — tha ai dhe zgjati dorën në drejtim të oficerit. Hiqmeti i dha dokumentat me të dhënat e fundit. Shefi i mori dhe filloi t'i studjonte në heshje. Në të njëjtën kohë edhe oficeri i ri nisi të shikonte eprorin dhe me ankth priste fjalën e tij, e cila do t'i vinte notën punës që kishte kryer. Në shkollë kishte kaluar me sukses shumë provime, por nuk kishte patur emocionin që kishte tani. Ky ishte provimi i parë i jetës!

— Hë! Ashtu, ë?.. Ti s'je i kënaqur nga puna jote? — pyeti shefi duke prishur qetësinë, pasi i dha fund së shqyrtuari materialit që kishte në dorë — Kurse unë mendoj se nuk ke punuar keq!

Ai as që i priste ato fjalë, prandaj u hutua. Megjithëse u gëzua për ato që dëgjoi, prapëseprapë nuk shfaqti asnjë shenjë vetëkënaqësie. Priti në heshtje.

— Si, s'beson? — e pyeti përsëri shefi — Duhet që të jesh i bindur: Me punën që ke bërë e do të bësh, me siguri që do ta zbulosh të vërtetën dhe autorin e krimit, «hijën e zezë»!

— Ajo është zhdukur — tha oficeri.

— Megjithatë gjurmët duhet t'i ketë lënë. Ato do t'i gjesh me siguri. Ku? Aty në vendin e ngjarjes, gjetkë. Kërko, bashkëpunohet me punëtorët, me masat!.. Ata do të të ndihmojnë.

«Interesant — tha Hiqmeti kur mbeti vetëm — Ky që flet me aq siguri sikur e ka në dorë «gjahun»!»

Këto mendime e bënë që si në ekranin e filmit, t'i përfytyrohej fizionomia e hequr e simpatike e shefit, flokët e tij me pak thinja, rrudhat e

fytyrës dhe sytë e mprehtë, që i flisnin qartë për përvojën e madhe në këto punëra.

«Ky mund ta zgjidhte vetë me lehtësi këtë lëmsh — mendoj ai — por ma ngarkoi mua dhe po më ndihmon që të eci me këmbët e mia. Po më ndihmon që të zbuloj gjurmët e së vërtetës.

Ku ishin ato gjurmë?

Ato duheshin kërkuar!

\* \* \*

Aty, në vëndin ku u gjet i plagosuri, Hiqmeti kishte kohë që çdo gjë e vërente me interes e hapat po i hidhte ngadalë. I pakënaqur nga që s'po gjente ato që kërkonte, u mat të largohej, por pikërisht ahëre, rrëzë murit, midis disa barishteve të thata, i tërhoqi vemendjen diçka e zezë. U afrua. Me kujdes largoi një gjemb të thatë dhe pa se ajo gjë e zezë ishte një levë e shkurtër prej hekuri të pastër.

— Po kjo?.. Çfarë do kjo në këtë vend? — pyeti ai duke vërejtur levën, sikur desh të merrte përgjegje prej saj. Por hekuri me majën e ngulur pak si pjerrët në tokë, qëndronte indiferent aty rrëzë murit, sikur desh që t'i shpëtonte syrit të njerëzve.

Duke shtjelluar përgjegjen për pyetjen që bëri, ngriti kokën dhe për disa çaste hetoi vëndin rreth e qark. Së fundi veproi. Nxori shaminë nga xhepi, e hodhi në pjesën e fundit të levës, e mori atë pa prekur në metalin e saj dhe u largua me hapat të sigurt!..

Objektin e dorëzoi për t'i bërë studimet e ne-

vojshme. Mbas kësaj filloi të ndjente një farë shqetësimi. «Mirë në daltë gjë pozitive prej analizave, po sikur të ndodhë e kundërta?» Mirëpo logjika filloi t'ja largonte shqetësimin. Nuk kishte arësye bindëse që ajo levë pa ndryshk, të ndodhej në atë vend krejt rastësisht.

Mos ishte kjo gjurma e kërkuar?

Mos ishte kjo mjeti me të cilin ishte kryer krimi? Apo mos ishte ndonjë objekt pa vlerë? Kjo duhej vërtetuar!

Si mbërriti në zyrë, Hiqmeti nxori menjëherë nga dosja raportin e mjekut dhe nisi ta studjonte edhe një herë. Mbas pak me lapës nënvizoi një frazë, të cilën e pëshpëriti me zë:

— «Plaga ka një prerje të drejtë, rreth pesë centimetrash, me një farë pjerrësie nga poshtë lart...»

Ai solli ndër mend levën dhe arriti në përfundimin se ajo ishte mjeti me të cilin ishte kryer plagosja e punëtorit. Ajo levë ishte gjurma e «hijes së zezë»! Po vetë «Hija» ku ndodhej?.. Kush ishte?.. Kjo ishte detyra kryesore por dhe më e vështira për t'u kryer.

\* \* \*

Tri ditë mbas këtyre ngjarjeve, Hiqmeti e ndjeu veten të kënaqur. Rezultatet e laboratorit kishin vërtetuar plotësisht mendimet e tij. Ishin zbuluar dhe shenjat e gishtërinjve të «hijes së zezë». Kjo për të ishte një sukses i rëndësishëm. Tani e shikonte veten në rrugë të saktë për të zbulu-

ar të vërtetën. Por kënaqësia e tij nuk zgjati shumë. Kur shefi e thërriti në zyrë, i dolën avaze të tjera, që as i kishte menduar.

— Mirë! Për gjithshka mirë! — i tha ai, pasi kishte dëgjuar raportin e tij — Po për deficitin e depos së ndërmarrjes, çfarë keni bërë?.. Oficerit të ri ju duk fare pa vend kjo pyetje, prandaj nuk vonoi t'i përgjigjej!

— Asgjë! Ç'lidhje ka deficitin e depos me këtë ngjarje, shoku shef? Deficitin që doli në depo para ca kohësh, ishte për pakujdesinë e magazinierit, prandaj me të drejtë, materiali i humbur, ju ngarkua atij!

— Mos u nxito — e ndërpreu shefi — Le të mendojmë për një çast se çështja që po hetojmë s'ka lidhje me deficitin e depos. Në qoftë se është kështu, ahëre si shpjegohet që «hija e zezë» lëviz pranë depos dhe jo pranë ndonjë vendi tjetër?

Hiqmetit i shëndritën sytë. Në këto fjalë ju duk se po shikonte shtegun për të kapur më mirë fillin e çështjes.

— Si?.. Të këtë lidhje? — pyeti ai me gjysmë zëri.

— E pse jo! Ne duhet t'i shikojmë faktet jo të shkëputura e në hava, por të lidhura e të ndërvarura. Me një fjalë në mënyrë dialektike.

— Kudo hyka dialektika — plotësoi tjetri.

— Natyrisht. Edhe diçka tjetër. Në materialin fillestar të hetimeve të tua më zuri syri dhe një gjurmë tjetër. Ç'kini bërë për të?..

— Asgjë, shoku shef.

— Përse?

— Sepse më duket pa rëndësi.



— Ashtu? Nuk do të bëjmë keq që ta shqyrtojmë së bashku edhe këtë, ndoshta del gjë.

— Si urdhëron — tha Hiqmeti që, pasi kapí shpejt e shpejt dosjen, vijoi — Ja, këtu janë gjurmët e një bidoni të gjetur në rërën e hedhur rreth shtatëdhjetë e dy metra larg depos, aty brenda murit të ndërmarrjes, pranë trungut të plepit të madh. Shenjat nuk janë dhe aq të qarta, por matjet dhe studimi i tyre vërtetojnë se këto janë gjurmët e një bidoni metalik, nga ata që zakonisht përdorin shoferët.

— Po! E... Ç'thuhet për këtë? — pyeti shefi.

— Mendoj se s'ka asnjë vlerë për çështjen që ne hetojmë — tha i bindur oficeri i ri.

— Ka të ngjarë që të jetë ashtu, por ka të ngjarë që të jetë edhe ndryshe. Ne na intereson më shumë kjo e fundit, prandaj mbas kësaj duhet të kapemi. Unë mendoj se asgjë nuk duhet nënvleftësuar. Shpeshherë nga një gjurmë fare e vogël mund të zbulohet një krim i madh — i dha fund bisedës së tij shefi.

\* \* \*

Ajo bisedë e shkurtër e interesante, si zakonisht, edhe kësaj here ishte një impuls për punën e Hiqmetit, megjithëse i nxori atij të tjera avaze të cilat kërkonin zgjidhje. Natyrisht një gjë e tillë nuk ishte aq e lehtë sa mund të mendohej, por ai nuk u shtang para vështirësive të reja.

Krahas përpjekjeve për të zbuluar «hijen e zezë», që ishte çështja kryesore, ai punoi edhe për sqarimin e defiçitit të depos.

Inventarizimi përfundoi — tha N/drejtori i ndërmarrjes.

— Si doli? — pyeti oficeri me kureshtje.

— Kësaj here çdo gjë në rregull. Nuk kishte diferenca — ju përgjegj ai duke i treguar një dokument. Tjetri e mori, e shikoi me vëmendje dhe, si bëri shënimet e nevojshme, solli ndërmend të dhënat e mbledhura si dhe rezultatet e inventarit që u bë tani mbas ngjarjes.

«Pra, asgjë më shumë se ato që diheshin» — tha ai me vete. Të gjitha këto e bënë të dyshonte se mos shefi i tij ishte gabuar kur kishte menduar se deficieti i depos kishte të bënte me plagosjen e punëtorit. Megjithatë s'desh t'i besonte këtij dyshimi, prandaj këtë çështje e la hapur si një problem që duhej ta vërtetonte koha; ndërsa për gjurmët e bidonit metalik, mendonte se ato ishin të rastit dhe s'kishte arsye të dyshohej që ato të bënin pjesë në kompleksin e ngjarjeve që hetonte. Sidoqoftë edhe këtë nuk e la mbas hore. Metodrat e punës dhe ndihma sistematike, që i jepte eprori, po e ndihmonin... «Të punonte me durim dhe t'i shpinte çështjet deri në fund!...»

Kështu, në vazhdim të punës së tij këmbëngulëse, konstatoi se nga parku i automjeteve të ndërmarrjes, ku kishte ndodhur ngjarja, ishte zhdukur një bidon! Data ekzakte e kësaj ndodhie nuk dihej. Shoferi që e kishte në ngarkim pohonte:

«Me siguri ma kanë vjedhur që nga data një deri më dhjetë gusht, kur unë isha me leje, se më përpara mbaj mend shumë mirë që e kisha...»

«Si?.. Është zhdukur prej datës një deri më

dhjetë gusht? Domethënë dy ditë para plagosjes së punëtorit! Të ketë lidhje?

«Në qoftë se është kështu, konkretisht përse mund t'i ketë shërbyer kriminelit ai bidon në këtë rast?»

«Jo, jo! S'duhet të ketë lidhje me plagosjen. Si duket bidonin e ka vjedhur ndokush për nevoja shtëpiake».

«Po pse kaloi andej?»

«Ai që e vodhi, natyrisht s'mund të dilte nga porta, se do ta kapte roja në hyrje, prandaj ka preferuar të largohet aty ku dhe muri i rrethimit të ndërmarjes është pak i rrëzuar...»

Në këto mendime e sipër kërciti dera dhe në hyrje u duk shefi dhe së bashku me të në zyrë hyri edhe një burrë rreth të dyzetave.

— Është punëtor në ndërmarjen ku ka ndodhur ngjarja — tha shefi duke i paraqitur qytetarin, të cilin e ftuan të ulej në karrigen aty përballë tavolinës së shkrimit. Fill pasi zunë vend, Hiqmeti u zgjati paqetën e cigareve e, si e ndezi dhe vetë, me vëmendje filloi të dëgjonte ato që po shpjegonte punëtori:

— Këto që do t'ju them, ndoshta nuk do t'ju vlejné fare, por sidoqoftë mua dyshimi nuk më lë të rri pa jua treguar. Ç'është e vërteta në fillim kësaj pune nuk i vura rëndësi, por duke u thelluar këto ditë, më duket se kam bërë gabim shumë të madh që nuk ju vura në dijeni menjëherë për të gjitha ato që pashë.

— S'ka gjë, flisni! Edhe tani mund të na ndihmoni — tha shefi. Qytetari shtërngoi kasketën që mbante në duar, bëri një pushim të shkurtër, sikur

të mundohej të rreshtonte më mirë ato që do të tregonte, pastaj nisi të fliste:

— Të pasnesërmen e asaj që na ndodhi në ndërmarrjen tonë, unë isha në punë turni i tretë, domethënë mbas mezit të natës. Siç ju thashë, punoj në oficinë. Ashtu pa zbardhur mirë dita, dola nga reparti për nevoja personale. Si u largova ndo njëqind metra, në anën tjetër të rrugës, pak më larg depos, më zuri syri një njeri që ishte përkuhur e diçka kërkonte me nxitim. Në fillim pandeha se ishte ndonjë kafshë, por pastaj vura re se ishte njeri!

— Diçka kërkonte? — e pyeti Hiqmeti.

— Po! Diçka kërkonte dhe ruhej se mos e shikonte njeri.

— Nga se niseni kur thoni që «ruhej se mos e shikonte njeri?» — ndërhyri shefi.

— Nga gjestet që bënte: Kërkonte me nxitim dhe përgjonte. Veç kësaj, kur unë, padashur, bëra zhurmë me ca hekurishta, ai u zhduk si era dhe nuk e pashë më!

— Si, nuk arrite ta njohësh? — pyeti Hiqmeti.

— Isha larg dhe në mugëtirë nuk ja pashë dot fytyrën!..

— Sa keq që nuk e njohët! — tha oficeri i ri duke shtypur në taketuke bishtin e cigares së papirë.

— Fytyrën vërtet nuk ja pashë, por nga të ecurit dhe nga duart që i mbante pak të hapura, sikur do të fluturonte, m'u duk se ishte Kalam Selimi! Kalami ecën ashtu.

— Kalam Selimi?.. Në mos gabohem, punon në ndërmarrjen tuaj — ndërhyri shefi i qetë.

— Po. Punon në sektorin e jashtëm të ndër-  
marrjes sonë — përfundoi qytetari.

Mbas kësaj bisede të shkurtër, ai u largua i  
shoqëruar nga shefi.

Hiqmeti që mbeti vetëm, nisi të mendonte:

«Kalam Selimi?.. Ky të jetë «hija e zezë»?»

«Ç'desh ai në atë vend?»

«Përse fshihej nga njerëzit?..»

«Ç'farë kërkonte aty në atë orë?..»

«Mos vallë kërkonte mjetin me të cilin kreu  
aktin që të zhdukte gjurmët e krimit?.. Në qoftë  
se është kështu, pse e hodhi aty levën dhe erdhi ta  
kërkonte më vonë?»

Për orë të tëra, në zyrë, i përkulur mbi mate-  
rialet e hetimit, Hiqmeti u mundua që t'i sqaronte  
këto pyetje, por nuk ishte e lehtë. Sigurisht që me  
këtë të dhënë, pak a shumë, vihej pika mbi i-në,  
por kjo akoma nuk mund të thuhej për derisa ako-  
ma nuk ishte dokumentuar se Kalam Selimi ishte  
«hija e zezë». Ju desh një punë e kujdesshme dhe  
këmbëngulëse për të vërtetuar se personi që kishte  
përdorur levën ishte vërtet ai për të cilin dysho-  
hej. Gjurmimet e më vonshme nuk vërtetuan ve-  
tëm këtë, por ato sinjalizuan se në këtë ngjarje  
Hiqmeti nuk kishte të bënte me një krim të thjeshtë,  
siç mendonte në fillim, por me një krim të ndër-  
likuar me karakter politik, që drejtohej kundër  
pushtetit popullor. Këtë gjë oficeri i ri e nuhati sa  
i ranë në dorë të dhënat që e ndihmuan të njihte  
jetën dhe veprimtarinë e Kalam Selimit!

«... Gjatë luftës ka qenë pjesëtar aktiv i orga-  
nizatës tradhëtare të «Ballit Kombëtar». Për të  
humbur gjurmët e veprimtarisë së tij, fill mbas

çlirimit të vendit, pasi shiti shtëpinë dhe pasurinë, braktisi fshatin e lindjes që ndodhej nja katër orë larg bregdetit jugëperëndimor dhe familjarisht u vendos në qytetin tonë.»

Mbas gjithë asaj pune intensive, Hiqmeti, jo vetëm që nuk ndjente lodhje si në fillim, por përkundrazi e ndjente veten të përtëritur se «hija e zezë» më në fund ishte zbuluar. Tani nuk mbetej gjë tjetër veç të nxirrte në shesh të gjithë të vërtetën e asaj ngjarjeje të komplikuar. Kjo e shtyn-te oficerin e ri që ta priste me padurim çastin kur do ta kishte përpara atë «hijen e zezë».

\* \* \*

Të dy qëndronin kundruall njeri-tjetrit. Mbas një heshtjeje të shkurtër, qetësinë e prishi Hiqmeti.

— E dini përse ndodheni këtu? — e pyeti ai.

— Jo, nuk e di — u përgjegj tjetri, që përpiqej të tregohej i qetë dhe indiferent.

— Mos u mundo të fshehësh krimin, por trego të vërtetën. Këtë e kam për detyrë të ta them qysh në fillim. «Dielli me shoshë nuk mbulohet», thotë një shprehje popullore.

— Unë s'di asgjë — nguli këmbë tjetri.

— Ashtu?.. Epo mirë ahëre. Po të ndihmoj unë — i tha oficeri, që nisi të fliste i qetë dhe i sigurt, sikur të kishte parë çdo gjë me sytë e tij. Duke argumentuar faktet, herë mbas here, me bisht të syrit kontrollonte efektin e fjalëve të tij te bashkëfolësi, i cili qëndronte si mbi gjëmba.

— S'janë të vërteta — tha i akuzuari me dëshpërim.

— Veç e vërteta është kokëfortë. Po për këtë çfarë do të thuash? — e pyeti oficeri që nga rafti nxori «levën» dhe ja vendosi përpara mbi tavolinë.

«Mos! E paska gjetur» — mendoj Kalami me sy të çakërryer duke shikuar levën dhe mallëkoi veten që atë djall hekuri, pasi goditi punëtorin, nuk e kishte vendosur mirë në rryp por nga nxitimi i kishte rënë pa e kuptuar. U kap ngushtë por s'desh të dorëzohej, prandaj u përgjegj.

— Ç't'ju them? Me sa shikoj unë, kjo është një «levë»...

— Që ju e keni përdorur për të kryer një krim — e ndërpreu Hiqmeti, i cili me dokumenta të pakundërshtueshme e sidomos me rezultatet e analizave laboratorike, i faktoi se Kalami ishte autori i krimit.

— Po, unë e kam goditur — u detyrua të pohonte ai kokulur. Duke shpjeguar shkaqet që e shtynë për një veprim të tillë tha: «Desha ta vrisja që të mos më zbulohej vjedhja...»

— Vjedhjen e ke bërë para disa muajsh; kurse kësaj here nuk shkove për të vjedhur, po për të djegur depon! Ja dhe gjurmët e bidonit me benzinë, që grabite nga parku i automjeteve.

Këto fjalë të oficerit, Kalamini e tronditën së tepërmi. Tani u bind se «po i dilnin lakrat sheshit», megjithëse spiuni i ardhur nga jashtë shtetit e kishte siguruar:

«Kurrë s'do të jenë në gjendje të të zbulojnë. Mos ki frikë. Me këtë plan kam parasysh që «mishi të piqet e heli të mos digjet». Kjo do të thotë:

Aksioni i bujshëm për të djegur depon e ndërmarrrjes ku ndodhen materiale me vlerë, të përfundojë me sukses, të mos zbulohet autori i saj dhe si fajtor të akuzohet magazinieri!..»

«Nuk është plan i keq, dakord jam edhe unë, por e kam ca vështirë, se jam vetëm — i qe përgjigjur Kalami që kishte dashur t'i bënte bisht detyrës, se kishte pasur frikë mos e pësonte.

«Jo, nuk është ashtu. Në Shqipëri ka edhe të tjerë si ti, që kanë humbur pozitën e pasurinë. Ata vërtet tani janë tulatur e s'guxojnë të dalin hapur për të nxjerrë inatet e vjetra, por kjo s'do të thotë se ata nuk presin ditën që të fitojnë ato që kanë humbur. Tani ka ardhur koha që këta njerëz t'i inkurajojmë. Ka ardhur koha t'i tregojmë botës se komunizmi në Shqipëri ka armiq jo vetëm jashtë por dhe brenda. Në nga jashtë po e bëjmë detyrën tonë: Në kufi vazhdimisht kërcet dyfeku. Pra, që të vijë sa më shpejt ajo që ëndërrojmë, edhe ju nuk duhet të qëndroni më vrimave si minjtë» — i kishte mbushur mendjen spiuni.

... Dhe Kalami po i zbatonte detyrat: Mundi të vidhte depon pa lënë gjurmë, dhe, meqë veprimi i tij nuk u zbulua, mungesat ja bënë në ngarkim magazinierit, si njeri i pakujdesshëm. Bile kishte nga ata që, me rezervë, menduan se ai i kishte përveçësuar materialet. Ky ishte edhe objektivi që duhej të arrihej: «Kur të digjej depua, magazinieri të akuzohej përfundimisht se e kishte djegur vetë ndoshta për të mbuluar gjurmët e ndonjë vjedhjeje tjetër më të madhe.

Këto mendonte i akuzuari ahëre kur dëgjoji pyetjen:



— Si do të veproje për të djegur depon?

Në pamundësi të bënte ndryshe pohoi i dërmuar:

— Si të hipja në çati, që nga baxhaja do të zbrazja benzinën mbi stivën e materialeve që arri- nin gati deri në trarët, pastaj do t'i vija eshkën e ndezur fitilit të dinamitit që do të shpërthente dhe flakët kishin për ta bërë shkumb e hi depon...

— Siç u bënë edhe planet e tua që të kishte ngarkuar agjentura e huaj — ja preu oficeri, i ci- li s'vonoi t'i provonte se ai nuk ishte vetëm kriminel ordiner, por dhe armik i betuar i popullit, agjent i spiunazhit të huaj!..

Kalami u bë limon i verdhë kur pa se e vërte- ta u zbulua plotësisht!

\* \* \*

Si sqaroi çdo gjë, Hiqmeti mbylli dosjen dhe shkoi tek dritarja. Hapi kanatet e saj dhe ajri i fre- skët i lëkundi flokët e zes. Hodhi sytë mbi pano- ramën e qytetit: Në qiellin e kaltërt zgjatej e zgja- tej tymi i fabrikave. Diku aty pranë, një grup fë- mijësh po loznin e qeshnin të gëzuar... Dukej sikur të gjithë po merrnin pjesë në gëzimin e atij, që kreu me nder detyrën e parë.

## MIDIS QARKUT TË KUQ

Në trotuar para bar-bufesë, u ndalën e biseduan me zë të ulët dy burra. Mbas pak hynë brenda në lokalin e mbushur plot me klientë. Në hyrje ata hodhën vështrimin rreth e qark, sikur kërkonin ndonjë vend të lirë.

— Ja ku është në qoshe aty pranë dritares. Eja mbas meje — i tha duke i pëshpëritur shokut Xhelua, që u nis në atë drejtim. Ilka e ndoqi pas. U afruan pranë tavolinës ku kishte zënë vend një djalosh, që dukej se nuk i kishte kaluar të njëzet e pesë vjeçët. I vetëmuar ai ja kishte shtruar me të pirë.

— Ka mundësi të ulemi dhe ne, o shok — i tha Xhelua duke e shikuar me bisht të syrit.

— Po si or jo! Urdhëroni, uluni — u përgjigj djaloshi me indiferencë, por kur hodhi vështrimin dhe e njohu atë që i foli, thërriti:

— Oj! Po ti qenke, o Xhelo? Po si je, bre Xhelo? Pse na mbahesh kaq më të lartë dhe nuk na flet, a derëbardhë?

— U... Miha!.. Më fal se nuk të pashë, për besë! — i tha Xhelua, që ju hodh edhe e përqafoi. Zunë vend nëpër karrige.

— Po këtë shokun nga e kemi? — pyeti djaloshi.

— Prej këtu, është një miku im. Merret me tregëti kafshësh — ju përgjigj Xhelua, që e theksoi këtë fjalë.

Bënë qejf nja tre katër orë, por rregulluan dhe punë. Në bisedë e sipër, ranë në ujdi që «tregëtari» t'i shiste djaloshit dy mushka të mira. Kur erdhi puna për çmimin, ndërhyri Xhelua, që ishte asnjans në atë mes, dhe ua rregulloi hesapin. Në përfundim, si paguan paratë për ato që kishin pirë, dualën nga pijetorja dhe, simbas marrëveshjes, u nisën për në vendin ku do të bëhej dorëzimi i mallit. Kështu, me muhabet, bënë përpjetë, andej nga lindja.

— Për besë mos u bëj pishman, se kam mushka shumë të mira. Të kam mikun e mikut dhe do të të lë të zgjedhësh në tufë — i tha rrugës «tregëtari».

— Të faleminderit e ta paça borxh, o Ilkë — ju përgjigj Miha me përzemërsi.

— Zemrat e mira. Zemrat e mira, vëllezër — foli Xhelua që tregohej më aktiv në muhabet.

— Ah! ta marrë dreqi — kërceu si papandehur Ilka.

— Ç'pate? — e pyeti Xhelua.

— Harrova një plaçkë këtu në një shtëpi. Nisuni përpara, se ju arrita — tha Ilka, që nuk priti të merrte leje por u largua për pesë minuta. Vërtet nuk u vonua, e mbajti fjalën. Më të dalë të qytetit, aty afër spitalit, u doli përpara. Në sup kishte hedhur një torbë gri me katrore.

— Shpejt ardhe — i tha djaloshi.

— Sa mora torbën — u përgjigj ai që mernte frymë më të shpejtë, gjë që tregonte se kishte nxituar.

Të tre, me muhabet, ndoqën pas mushkën e Mihas, që e kishte ngarkuar me plaçka deri në vesh. Në përrua, aty te gryka e malit, Xhelua ju afrua kafshës dhe bëri sikur i rregulloi mushamanë që i varej, por në fakt, me marifet, preu me thikë një litar dhe pak metra më tutje barra e kafshës u anua. Miha shau mushkën me rrënjë e me degë dhe filloi të ngrinte plaçkat e rrëzuara për tokë. Mbrapa tij, Xhelua dha sinjalin. Me të shpejtë, Ilka nxori «nagantin» dhe qëlloi dy herë me radhë. Djaloshi ra përmbys i vdekur. Kafsha rendi e trembur. Ilka mbeti me revolver në dorë, kurse Xhelua u turr mbi djaloshin e shtrirë. Me thikë i preu kordonin me të cilin kishte lidhur kuletën e mbushur plot me para dhe, si i copëtoi edhe xhaketën, së bashku me vrasësin tjetër u largua me nxitim.

\* \* \*

Vrasja e djaloshit për një kohë të gjatë mbeti enigmë.

Kush ishte krimineli?

Pse e bëri atë vrasje?

Organet që merreshin me hetimin e ngjarjes, nuk kishin asnjë bazë konkrete për t'u dhënë rrugë këtyre shqetësimeve. Nga hetimet dhe konkluzionet e nxjerra në vendin e ngjarjes, rezultonte se krimi duhej të ishte bërë për qëllime grabitjeje.

Këtë arësytim e forconte dhe portofoli me para që i qe marrë viktimës.

Ky të ishte shkak?

E pse jo, por edhe ndonjë shkak tjetër nuk përjashtohej.

Oficer Zisi, që punonte për të njohur këtë të fshehtë, vërtet ndodhej në rrugëkryq. Për t'ja dalë mbanë, ai studjonte me kujdesin më të madh dhe hollësinë më të vogël, çdo gjë që i përkiste asaj vrasjeje. Rëndësi të veçantë u jepte deponimeve të qytetarëve. Sa herë që i paraqiteshin, linte çdo punë që kishte nëpër duar, se s'donte të humbiste asnjë rast, nga i cili mund të përfitonte shumë. Ashtu veprroi ai edhe atë mesditë. Qytetarin që e priste në hyrje, urdhëroi ta lejonin t'i vinte në zyrë. Atë e quanin Llaqi. Ishte një meso-burrë rreth pesëdhjetë vjeç, i veshur me rrobe të reja shajaku dhe në kokë mbante një kasqetë ngjyrë gri. Vetullat e zeza dhe mustaqet e tij pak të përdredhura e tregonin njeri të pjekur. Sa u duk në hyrje, oficeri krijoi përshtypjen e parë se duhej të ishte një tip i mprehtë. Të paktën kështu e tregonte fizionomia dhe mënyra se si përshëndeti:

— Tungjatjeta!

— Tungjatjeta! Urdhëroni, uluni — e ftoi oficeri. Ai dalëngadalë, zuri vend në karrigen që i treguan. Ndezi cigaren që i dha oficeri dhe pastaj tregoi shkaqet që e kishin nxitur të vinte aty në degën e punëve të brendshme. Fliste i matur dhe i qetë. Gjatë gjithë kohës, Zisi e dëgjoi me vëmendje, pastaj e pyeti:

— Simbas teje, cili duhet të jetë shkak i vrasjes? — Këtë e bëri ngaqë desh t'i dëgjonte edhe një herë disa mendime të Llaqit.

— Me sa ma pret mendja mua, dhe siç e kam njohur, Miha ishte një djalë çapkën dhe shumë merak mbas femrave. Nga kjo them se do ta kenë vranë për punë dashurie. Siç duket, i ka rënë ndonjerit bela në pjesë dhe e vrau. Keq më vjen, se ishte i ri, por kur përzihet njeriu në këto punë të palezeçme, shoku Zisi, dihet si përfundon.

— Mos kini gjë dijëni se me cilat femra ka patur marrëdhënje Miha? — e pyeti përsëri oficeri.

— Si të të them dhe unë! S'njoh ndonjerën, por kështu flitet tutje e tëhu!, këtë di të them, — i vuri kapak deponimit të tij Llaqi.

Tjetër ngatërresë!

«E vranë për arësye grabitjeje!.. E vranë për punë dashurie!..» Çështja u ndërlikua dhe u fut në një rrugë pa krye!

\* \* \*

Llaqi fërkoj duart dhe u krekos me fodullëk kur po u tregonte dy të tjerëve se si kishte marrë guximin e kishte shkuar në degën e punëve të brendëshme për të bërë deponimin. Vërtet ishte topall e kur ecte lëkundej si maqina kur i thyhet balestra, por ama nga goja qe brisk. S'ja hante qeni shkopin, që thonë!

Pak kohë pas vrasjes së djaloshit. Xhelua e pyeti Ilkën:

— Pse rri kështu i mërzitur?

— Kam frikë se mos na zbulojnë — ju përgjegj ai.

— Mos u frikëso! E ujdís unë atë punë!

— Si do ta ujdísësh?

— Kam menduar një plan! Atyre të sigurimit do t'jua prishim mendjen që të mos na gjejnë për njëmijë vjet. Do t'u themi se Mihan e vranë për punë dashurie!

— Të vemi si cjapi te kasapi — ja preu Ilka i trembur.

— Jo, bre, nuk e tha njeri atë llaf! Dëgjo këtu si e kam ujdishur planin: Kam unë një mikun tim. E quajnë Llaqi. Edhe ti e ke parë po nuk e njeh mirë!

— Kush është ky Llaqi?

— Magazinieri i ndërmarrjes sonë.

— Llaqi çalua — tha Ilka.

— Çalo vërtet është nga këmba, por nga goja është avokat! Avokat i madh! Me siguri ai do t'jua bëjë mëndjen çarçaf dhe s'kanë për të na zbuluar — e siguroi Xhelua.

Ilkën, që mbas vrasjes nuk e mbante vendi, sikur e ngrohën ato fjalë, por prapë besoi me dyshim, ndërsa tani, kur dëgjonte Llaqin që u tregon-te se si i kishte ngatërruar ata të degës, po bindej me gjithë mend se ky Llaqi qenkej një dhëlpër plakë, që e futi sigurimin në qorrsoak nga i cili zor se dilte kollaj.

— Ju më thoni se Mihan e vranë për çështje dashurie, më pyeti ai i degës, — vijoi të tregonte Llaqi — po portofolin me para pse ja muarën, më tha. Mua m'u qesh! «Po kur gjen njeriu para pse të mos i marrë, o shoku Zisi?» — i thashë!..

— Hë më të lumtë! Ja paske zënë gojën — e lavdëroi Xhelua, që pinte duhan i heshtur e duke

dëgjuar, herë mbas here vjedhurazi, kontrollonte përshtypjen që linte ajo bisedë tek Ilka.

— Ja hodha vërtet, por dijeni se ai Zisi është shumë i tmerrshëm! Po që se bie në dorën e tij, ta merr shpirtin pa një pa dy! Le që kështu janë të gjithë këta të sigurimit. Zoti të ruajtë prej tyre! Po ju mos u bëni merak! Veproni me mend në kokë. Sa të kem mundësi edhe unë do t'ju mbroj!

— A.. të falemnderit shumë — e ndërpreu Ilka, që s'dinte se si t'ja shprehte mirënjohjen.

— Po si, ore, s'do t'ju mbroj! Do t'ju ndihmoj e do t'ju mbroj me sa të më jepet, se jemi miq. Që thoni ju, vëllezër, me miq e me shokë kalohet jeta! Me miq e me shokë njeriut nuk i hyn gjemb në këmbë!

— Ashtu është. Ta paçim borxh, o Llaqi — shtoi Xhelua.

— Ndize — i tha çalua shokut duke i zgjatur paqetën «Diamant» mbasi u largua Ilka — Kaq e pati dhe ky që iku.

— Kur të vejë puna në fund — tha Xhelua.

— Jo, mik. Mbaroi dhe kjo mesele. Që tani e kemi hedhur në kurth e nuk na shpëton dot. Ai vrau, vodhi. Të bjerë në dorë të këtyre e di mirë se çfarë e pret. Megjithatë detyra jonë është që t'i fusim frikën për njerëzit e qeverisë që t'i duket sa më e lehtë rruga jonë.

«Rrufjan i madh është! Bukur di t'i kurdisë këto punë» mendoi Xhelua duke tundur kokën me buzë në gaz. Nuk mendonte keq. Llaqi Krasaku vërtet ishte i tillë. Dinte të thurte e të realizonte plane nga më të rrafinuarat. S'kishte ndonjë arë-



sim të lartë, por për atë zanat, zëre se kishte marrë universitetin. Me një fjalë ishte i zoti! Që ishte bërë i tillë, meritë kishte edhe «profesori» i asfalias greke, Bakopullos, që e kishte stërvitur me zell. Kishte shumë kohë që ky i fundit e kishte rekrutuar agjent. E paguante mirë dhe në rregull çdo muaj, por nuk i kishte ngarkuar ndonjë bela. Një ditë prej ditësh, «profesori» e kishte thërritur urgjent në zyrë dhe i kishte thënë:

— Do të të bezdis me një punë, agapite 1) Llaqi.

— Urdhëroni flisni! Si është puna?

— Andej nga Shqipëria, gjermanët e ballistët po i lajnë hesapet. Me sa duket i kanë ditët të numëruara. Në fuqi po vijnë komunistët. Kjo gjë nuk është aspak në interesin tonë. Ata janë pengesë e madhe që ne të realizojmë çlirimin e Vorio Epirit!

— Si urdhëron — i qe përgjigjur topalli, që akoma nuk po merrte vesh se ç'lidhje kishte situata e Shqipërisë me detyrën që do t'i ngarkohej atij.

— Keq më vjen se do të largohesh nga patri-dha, se do të ndahemi për ca kohë, por e kërkon puna që ti sa më parë të hidhesh në Shqipëri. Duke qenë aty, do të na ndihmosh që ne të realizojmë qëllimet tona të shenjta!

— Malista qirje 1) — i qe përgjegjur Llaqi, që nuk e kishte bërë fjalën dysh.

Çlirimi i plotë i Shqipërisë e gjeti atë pranë farëefisit, aty ku i thanë. Që ditët e para u tregua

---

1) Agapite — i dashur (gr.)

2) Malista, qirje — si urdhëron, zotni. (gr.)

njeri i vendosur dhe përkrahës i flaktë i pushtetit popullor. Veç ta shikojë! Si magazinier që e caktuan, kujdesej për mallin e shtetit si për mallin e tij.

«I pandërgjegjshëm! Mos bëj kështu, se është malli i popullit» i shfrynte ai cilitdo, kur i konstatoonte ndonjë shpërdorim. I këpuste njëmijë e një dhe e bënte për pesë para!

Ky ishte Llaqi, që për pushtetin «bëhej copë», kurse Llaqi i saktë, ishte një «akrep» i rrezikshëm siç e kishte dhe pseudonimin, që i kishte ngjitur «profesori». Detyrat që i qenë ngarkuar këtij «akrepi» ishin të qarta e të përpunuara simbas një plani të hartuar me hollësi dhe kujdes:

«...Të punonte me tërë forcat dhe zotësinë për të rekrutuar agjentë, të ngrinte organizatën antikomuniste dhe, duke organizuar luftën e armatosur, të ndihmonte ushtrinë fashiste greke për të rrëzuar pushtetin komunist në Shqipëri, që të çlirohej Vorio Epiri!..»

Kur filloi nga puna për të vënë në zbatim këtë plan, mendoi se do të ishte vetëm, por «profesori» që gjithmonë kujdesej për të, shpejt i vuri në dispozicion një ndihmës jo më pak të zotin: Xhelo Grerën! Agjentin e fashistëve italianë që nga viti 1939, më vonë agjentin e nazistëve gjermanë e së fundi agjentin e asfalias greke! Nga pamja e jashtme ky njeri dukej sikur nuk e ngrinte qimen nga qulli. Por jo! Krejt tjetër qe e vërteta. Prandaj i kishin ngjitur dhe pseudonimin «Thëngjilli». Në zanatin e tij qe bërë mjeshtër. Zbatonte çdo detyrë me përpikmërinë më të madhe, që të bëhej i pasur siç ja hiqte dera. Për këtë e kishin dashur e çmuar padronët e parë, për këtë e donin dhe «e respekto-

nin» dhe këta të fundit. Veçanërisht «Akrepi» mbe-  
ti shumë i kënaqur nga veprimet e tij për vrasjen  
e djaloshit.

\* \* \*

Që të nxirrej në shesh e vërteta, organet e pu-  
nëve të brendshme vazhdonin gjurmimin në drej-  
time të ndryshme. Ndër të tjera, këto gjurmime  
shpunë dhe në përcaktimin e personave që ishin  
parë të binin në kontakt me djaloshin atë ditë, pa-  
ra se të ndodhte krimi. Në të dhënat e mësipërme  
figuronte edhe emri i Ilkë Zhuzhakut, që së bash-  
ku me Mihan dhe një «burrë të panjohur» kishin  
pirë në bar-bufe. Si e kishte studjuar çështjen the-  
llë, Zisi këtë fakt e nënvizoi me ngjyrë të kuqe në  
prezencë të bashkëpunëtorit të tij.

— Se kanë pirë me të, ky nuk është argument  
që tregon se janë autorët e krimit — arësyei Qe-  
mali, që e vuri re veprimin e shokut me të cilin Zi-  
si desh të thosh: «Këtu duhet të qëndrojmë!»

— S'dihet — u përgjigj i qetë oficeri, që ako-  
ma nuk e kishte lëshuar nga dora stilolapsin e kuq.

— Pse s'dihet?

— Them s'dihet, se gjithmonë ne duhet të sho-  
him të dy anët e medaljes. Fakti që pinin së bash-  
ku, mund të mos jetë i rastit — vijoi Zisi — Pas-  
taj s'duhet harruar që ai «burrë i panjohur» është  
parë ta shoqërojë djaloshin deri para spitalit, në të  
dalë të qytetit. Kush na siguron se nuk ka qenë me  
të deri në vendin e vrasjes?..

— Po, kini të drejtë — tha nëpër dhëmbë Qe-

mali, që ra në mendime. Mbas një pauze të shkurtër, ai pyeti: Pra, është e domosdoshme që ta gjej-më se kush është «burri i panjohur», shoku Zisi?

— Patjetër! — tha ai.

U desh një punë e gjatë, e ndërlikuar dhe e kujdesshme që të zbulohej se «burri i panjohur» ishte Xhelo Grera!

— Xhelo Grera? Po ky? Kush është ky Xhelo Grera? — pyeti Qemali kur mësoi për herë të parë emrin e «burrit të panjohur».

— Duhet ta njohim — u përgjegj prerë Zisi, i cili mendonte se këtu ishte filli i lëmshit të ngatërruar. Në këtë lëmsh duheshin gjetur kriminelët dhe veçanërisht arësyeja për të cilën u krye krimi. Kjo e fundit ngjallte dyshime, mbasi hetimet e bëra në vendin e ngjarjes dhe të dhënat e mbledhura më vonë, jo vetëm që nuk afroreshin me njëra-tjetrën, por në disa raste ishin dhe kontradiktore.

— Ja, edhe kjo më shqetëson! Mos kemi të bëjmë me ndonjë plan të djallëzuar, që i kalon caqet e krimit ordiner?.. Koha do ta vërtetojë — tha Zisi që nga ajo vrasje me të vërtetë kishte hyrë në telashe!

\* \* \*

Më shumë se kujt do tjetër, nga ajo vrasje, koka i lëshonte tym Ilkë Zhuzhakut. Ai shpeshherë mallëkonte veten:

«Ç'm'u desh mua kjo punë, ta marrë djalli, ta marrë!»

Mallëkime të tilla, ishin «shirk mbas të vje-

lash», se ato nuk kishin forcë që ta tërhiqnin nga rruga e rrezikshme ku ishte futur. Këtë rrezik e kuptoi shumë vonë. Më përpara kishte pandyer se çdo gjë rridhte krejt rastësisht. Nuk kishte kuptuar e as që mund të kuptonte se edhe laku i ishte hedhur me kujdes.

Dhe ja se si: një ditë të dy «miqtë» qëndronin kokë më kokë.

Xhelua ishte i pari që ra në të.

— E gjeta atë që kërkojmë — tha ai me qejf.

— Kush është? — e pyeti Llaqi.

— Ilkë Zhuzhaku. Punon në ndërmarrjen tonë.

— Nuk e njoh!

— Ke hakë! Ndërmarrja ka shumë njerëz, po ke për ta njohur së shpejti!

— Patjetër. Duhet filluar nga puna me të, por me kujdes — e kish këshilluar Llaqi.

Xhelua, si njeri i rrahur me vaj e me uthull në këto hesape, ju ngjit nga pas «gjahut» me bukë në torbë. Deri ahëre, Ilkë Zhuzhakun, e njihte vetëm si fytyrë e nuk kishte patur rast që të shoqërohej me të, prandaj dhe s'mund t'i afrohej menjëherë, u mundua larg e larg që t'i zbulonte pikat më delikate të karakterit.

Një mesnatë Ilkë Zhuzhaku, që s'mund të hiqte dorë nga vesi i tij, me pakon e vjedhur si dhe herët e tjera, kaloi për mrekulli murin rrethonjës të ndërmarrjes. Mirëpo pikërisht ahëre kur mendonte se kishte shpëtuar pa u diktuar, i ngriu gjaku se dëgjoi:

— Qëndro aty! Mos luaj! — i tha një zë burri me ton të ulët.

Ilkës i ra pakua nga dora dhe dridhej i tëri. Ai

që thërriti ju afua, e kapi për xhakete dhe e tërhoqi rrëzë murit pranë ferrave. Kur e kishte fare pranë, Ilka e njohu Xhelon që e pyeti me të butë:

— Pse dridhesh kështu?

— Aman, mos më kallëzo! T'u bëfsha kurban. Nuk bëj më! Po deshe, këto që kam marrë, i ndajmë bashkë — tha Ilka.

— Mbaji për vete, se je hallexhi. Mbaji e mos u tremb nga unë, por ruaju nga të tjerët. Ti nga e keqja po vjedh. Unë të kam pikasur edhe herë tjetër që ke vjedhur materiale të ndërmarrjes, po nuk të kam dalë në sy. Sonte të dola këtu, se ti nuk po ruhesh e do të marrësh veten në qafë. Hajde, tani, ikë shpejt këtej nëpër kanal, se mos të të diktojnë — i tha Xhelua duke u ndarë prej tij.

Ilka humbi në errësirë, por frika se mos Xhelua e hante në besë dhe e kallëzonte që kishte vjedhur, nuk e la të qetë edhe shumë ditë mbas asaj nate. Mirëpo me kalimin e kohës, po i mbushej mendja se e kishte gabim kur mendonte ashtu, mbasi Xhelua na qenkej shpirt njeriu e jo llafë! Jo që nuk kishte zemër t'u bënte keq të tjerëve, por me sa kishte fuqi edhe i ndihmonte në hallet e tyre. Këtë gjë Ilkë Zhuzhaku e provoi vetë dhe s'ishte e nevojshme t'ja thoshte bota. Mbas asaj që i ndodhi, kurdoherë që e takonte në rrugë, të dy i shtërngonin dorën njëri-tjetrit si miq të vjetër dhe ai bënte sikur s'dinte asgjë për vjedhjen që kishte bërë Ilka: Jo vetëm kaq, por meqë ky i fundit ishte ngushtë nga paratë, «i bëri hall» dhe i dha «hua» tridhjet e pesë napolona dhe kurrë nuk e shtrëngoiti t'ja kthente.

Me gjithë këto «të mira», Ilka s'kishte se si të

mos e respektonte dhe të mos lidhte shoqëri të ngushtë me Xhelo Grerën, që për të ishte kujdesur si për veten e vet.

— Hollë je dhe ti, o Ilkë! Nuk i dilet me një rrogë — i qante hallin një ditë Xhelua.

— Ashtu është, por ç't'i bësh? — ju përgjegj Ilka.

— Më ke hyrë në zemër e të dua, se je xhanan njeri. Se të dua prandaj do të të them një llaf.

— Folë, bre!

— Do të flas se më ke besuar dhe do të të besoj!

— Llaf është ai që të mos i besojmë njëri-tjetrit?

— Kam menduar që së bashku të bëjmë një punë që të dyve do të na bëjë të pasur — i tha Xhelua, që ja solli bukur idenë e vrasjes së djaloshit. Propozimi Ilkës i ra si bombë. Ai u lëkund, se s'desh të pranonte, por dhe për të kundërshtuar s'mundej, se i prishte qejfin Xhelos, që e kish të në dorë dhe që nguli këmbë t'i mbushte mendjen:

— Të thashë: bashkë do ta vrasim! Do ta vrasim, se jeta është luftë, or t'u mbylltë! Si vihet pasuria thua ti? Mos ta fal njeri?.. Me djersë shkrihesh si qiriri dhe mbaron me barkun thatë, kurse me marifete, me kobure, të vjen peshku i tiganisur majë malit!

Tjetri akoma nuk po vendoste.

— Akoma s'po të mbushet mendja ty — o? Pse, ore, ç'kujton ti? Si i kanë vënë kapitalet tregëtarët e milionerët, duke u mbirë kazma në dorë? Jo, or jo! Kështu i kanë vënë! Kështu janë bërë të pasur. Dhe në këtë dynja, po nuk pate para, s'ta

var njeri torbën, kurse po e pate xhepin plot, të duan e të respektojnë të gjithë.

Ilkës ju bë mendja çorbë: Për një kohë të gjatë dëgjoi gojëhapur e nisi të arësytonte:

«Ky njeri po më flet me zemër në dorë. Kandonjë interes nga unë që më flet kështu? Jo!..

«E po ahëre duket që më do të mirën! Pse të mos u besoj fjalëve të tij dhe të bëj siç më thotë?»

— Dakord jam — i tha ai Xhelos, që i shtrëngoi dorën dhe të dy, kokë më kokë, kurdisën planin e vrasjes së djaloshit të pafajshëm, që ra viktimitë e një qëllimi shumë të rrafnuar.

Miha, në çdo dy ditë zbriste në qytet dhe shiste bulmet e zinte shumë para, që gjithmonë i mbannte me vete, prandaj nuk duhej humbur rasti. Nangantin e bëri hall Xhelua, që e mori «hua» nga Llaqi, i cili edhe ky nuk u kursye. Kështu, çdo gjë u krye siç ishte parashikuar.

Po shpirtgjerësia e Xhelos u duk sidomos mbas vrasjes. Portofoli që i muarën të vrrarit kishte brenda treqind e njëzet e katër napolona. Si i numëroi, për veten e tij Xhelua mbajti vetëm njëqind e njëzet e katër dhe të dyqind napolonat e tjera, me gjithë kuletën prej meshini, ja dha Ilkës duke i thënë:

— Merri e t'u bëfshin mirë!

— Të falenderit shumë — i tha Ilka, që me gjithë mend nuk e priste kurrë një ndarje të tillë.

— Merri e t'u bëfshin mirë, se je hallexhi i tha Xhelua përsëri duke i shtyrë portofolin me para.

Mbas këtyre fjalëve, Ilka vendosi kuletën në xhepin e brendshëm të xhaketës. Prej atij çasti



ndjehej i kënaqur, se e kishte xhepin plot, por pasojat e veprës së tij filloi t'i ndjente ndonjë vit mbas vrasjes së djaloshit.

Një mbrëmje, topalli i thërriti urgjent, së bashku me Xhelon. Që në fillim u duk se kishte ndonjë hall të madh.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti i trembur Xhelua, që u hoq sikur nuk kishte dijeni fare për ato që do të bisedoheshin.

— Këta të sigurimit më duket se kanë rënë në erë të atyre që kanë bërë vrasjen e Mihas!

— Mos, more! — u hodh përpjetë Ilka, që i besoi me tërë mend, se ai «ishte qerrata i madh» e futej dhe në degën e punëve të brendshme. Si duket aty do t'ja kishte zënë veshi dhe këtë haber.

— Po ju mos u trembni, se do t'i dalim së keqes përpara — u dha kurajo Llaqi, që uli kokën sikur të mendohej ç'duhej bërë.

— Si? — pyetën të dy të tjerët pothuajse në një zë.

— Prandaj ju kam thirrur që të marrim masa.

— Hape gojën, bre!.. Gati jemi të bëjmë si të na thuash e ndërpreu Xhelua.

— Po ju kapën, ajo dihet që do t'ju vrasin, or vëllezër, por unë kam në dorë që ju të mos pësoni asgjë. Nga kjo them që tek të na vrasin ata, më mirë t'i qërojmë ne nga faqja e dheut!

— Si? — pyeti i trembur Ilka.

— Mos u nxito se do t'jua shpjegoj: Unë, që thatë ju, kam një mikun tim jashtë shtetit. Është kokë e madhe dhe merr vesh shumë nga këto punë. Ai më ka dërguar lajm se kjo qeveri nuk e ka

të gjatë, shumë-shumë gjer nga fundi i këtij viti, prandaj të ngrihemi kundër saj!..

— Ë?... Kundër qeverisë? Jo, jo, amani mua mos më ngatërroni në këto punë, se nuk e bëj dot! — u lut Ilka, që atë çast e ndjeu rrezikun.

— Mendohu mirë e pastaj fol — ja preu vrazhdë Llaqi. Ilkë Zhuzhaku në atë heshtje të shkurtër ra në mendime, pastaj ktheu kokën nga Xhelua, që e quante se ishte në të njëjtat pozita me të.

— Unë, për veten time jam dakord veç të shpëtojme kokën dhe të ketë para — tha Xhelua, duke u shtirë sikur vërtet ahëre për herë të parë pranonte që të futej në një valle të tillë. Mbas Xhelos, Ilkë Zhuzhaku, i zënë ngushtë, jo vetëm që pranoi të hynte në këtë valle, por pranoi t'i jepnin edhe shaminë, që ta dridhte në fazën e dytë të operacionit «Shigjeta në shenjë».

Me mbarimin e fazës së parë, «Shigjeta» ishte gati.

Kush ishte kjo «Shigjeta»?

Agjenti i porsarekrutuar, Ilkë Zhuzhaku!

«Akrepi» e «Thëngjilli» nuk e rekrutuan kot së koti Ilkë Zhuzhakun. E zgjodhën dhe e bënë për vete, se ai ishte personi më i përshtatshëm për ta drejtuar në shenjë.

«Shenja» ishte oficeri i zbulimit, Lefti Ngjellani, për të cilin spiunazhi i jashtëm kishte shumë nevojë dhe donte ta vinte në shërbim të tij me çdo kusht. Këtë oficer, Ilkë Zhuzhaku e kishte kushëri nga e ëma kështu që mund të vepronte me lehtësi për ta rekrutuar. Natyrisht operacioni «Shigjeta në shenjë» ishte i vështirë. Të bëjë për vete një oficer e për më tepër një zbulues, ishte punë me spec, se

mund të binin vetë brenda kokë e këmbë, por «Ak-repi», që drejtonte, kishte besim se do t'ja arrinte qëllimit. Ja nga nisej ai që mendonte kështu:

Lefti, si oficer, ishte i zoti, por dalëngadalë në personin e tij filluan të nxjerrin kokë e të rriten disa vese jo të, mira. I pëlqenin qejfet e tepëruara dhe, me rast e pa rast, pinte, aq sa nganjëherë ishte bërë dhe tapë. Megjithëse ishte beqar dhe merrte rrogë të mirë, prapë kishte raste që merrte borxh nga shokët.

Kjo ishte «kleçka» ku duhej kapur puna në fillim. Agjentura e huaj ruante rezerva shumë më të shëndosha për Lefti Ngjelanin, që kishte menduar t'i vinte në përdorim kur t'u vinte radha.

Pas kësaj, «Profesori» dha aprovimin që të fillohej nga veprimi. «Shigjeta» u lëshua në «Shenjë». Ilka sipas porosisë, ruajti momentin, një nga ditët e fundit të muajit, kur Lefti ishte pa lekë në xhep.

— Ç'ke? Pse më je pa qejf, o kusho? — e pyeti ai.

— Kam mbetur fillosh — ju përgjigj ai duke lëvizur gishtin diftues poshtë gishtit të madh.

— Po pse nuk më thua! Na, ore, se të jap unë — i tha Ilka, që atë priste dhe nxori nga xhepi gjashtë napolona e ja lëshoi shuk në dorë. Kjo skenë u përsërit edhe disa herë të tjera. Lefti, që gjeti «bankën» ku mund të merrte kredi, u mësua. I merrte borxh e herë ja kthente në kohë, herë ja linte për muajin tjetër. «Kushua» as që çante kokën shumë për vogëlsira të tilla.

«...T'i jepte para borxh sa herë që t'i kërkonte dhe të mendohej ta tërhiqte sa më shumë pas të pirit!..»

Ja cila ishte detyra e parë që ju ngarkua «Shigjetës». Si kaloi një kohë, ky veprim ja arriti qëllimit të parashikuar: Të dy kushërinjtë u lidhën shumë ngushtë me njëri-tjetrin. Këtu s'kishte ndonjë gjë për të dyshuar! Ishin kushërinj!..

«Shigjeta» u udhëzua të bënte më përpara. Kjo ishte etapa më e rrezikshme, që kërkonte kujdes të madh, por kushtet sikur ishin pjekur, prandaj, një mbrëmje, kur të dy kushërinjtë ja kishin shtruar në pijetore dhe pinin. Ilka, ashtu si të gjendej në llaf, na hapi një bisedë:

— More vesh gjë ti, o Lefti? Më thanë se atë inxhinjerin që sabotoi e dënuan me vdekje. Është e vërtetë?

— I lau sahanët!

— Rëndë sikur e dënuan, bre kusho!

— Po të binte në dorën time, unë do ta rripnja të gjallë u përgjigj Lefti, që e shikoi seriozisht drejt në sy pastaj vazhdoi të përtypë një copë mëlçi, që kishte futur në gojë.

Ilkë Zhuzhaku e njihte mirë kushërinë e tij Lefti Ngjelanin. Ky rridhte nga një shtresë e mesme qytetare dhe në të kaluarën kishte jetuar mirë, por kishte dalë partizan, kishte luftuar, e gjatë kësaj periudhe ishte dalluar si njeri i sakrificës. Këtë gjë e tregoi në mënyrë të veçantë në fillim të vitit 1943, kur akoma punonte në terren. Ahere, në një përpjekje që bënë forcat territoriale të krahnës me fashistët, ai mori një plagë të rëndë në shpatull, nga e cila vuajti mjaft. Megjithëse kjo plagë s'po i mbyllej, ai pa u shëruar mirë dhe në kundërshtim me këshillat e mjekut, rrëmbeu pushkën e u bashkua me shokët e brigadës ku luftoi de-

ri në çlirimin e plotë të vendit. Mbas çlirimit u bë oficer, u pranua në parti!..

Të gjitha këto kishin ndikuar në formimin e tij, prandaj duhej kujdes. Përgjigjja e prerë që dha se po të binte në dorën e tij, ai do ta rripte të gjallë, e frenoi Ilkën, i cili atë natë e mbylli bisedën. Por tentativa të tilla ai i vazhdoi edhe për shumë herë të tjera. Në përfundim të të gjitha këtyre përpjekjeve, «Shigjeta» arriti në konkluzion:

— Është e pamundur të hidhet në dorë! Po të vazhdoj të flas me të hapur, rrezik se do të na mbërthejë — i raportoi ai «Akrepit», i cili ja priti pa mbaruar fjalën.

— Ke të drejtë. E kishim parashikuar dhe këtë, por do të përdorim rrugë të tjera. Ke për të parë si do ta bëjmë të vijë të raportojë në këtë tavolinë — i tha ai me një bindje të tepëruar duke goditur me gishtin diftues një arkë bosh që kishte përpara.

Plani i veprimit ishte i thjeshtë, i guximshëm, por mbi të gjitha shumë i djallëzuar. «Shigjeta» do të bënte goditjen kryesore, «Thëngjilli» goditjen anësore ndërsa «Akrepi» kishte timonin.

\* \* \*

I pari filloi «Shigjeta». Të dy kushërinjtë kishin dalë shëtitje gjer lart nga kodrat piktoreske të qytetit. Lefti pinte cigare mbas cigaresh. Ishte shumë i mërzhitur kohët e fundit. Kishte kaluar dyzet vjeçët dhe mezi që kandisur të fejohej. Po të ishte sa për atë, as që kish për t'u fejuar, por nje-

rëzit e shtëpisë e sidomos shoqëria nuk e kishin lënë rehat, prandaj edhe ai më në fund qe bërë burrë: kishte vendosur e qe fejuar me një vajzë të lezetshme. E kishte zgjedhur jo vetëm se qe e bukur, por pse kishte dhe mall. Ishte vajzë e vetme dhe babai i saj, që kish vdekur në kurbet, siç thuhej, së shoqes i kishte lënë «para të hazërta»! Vështirë e kishte pasur sa e kishte thurur atë mblesëri, se ky ishte i «krishterë» e ajo «myslimane», por prapë e kishte vënë punën në vijë. Që u fejua, nuk qe bërë pishman, por ç'e do se nuk po i shkonte mbarë. Në fillim, vajza nuk kishte thënë asnjë fjalë, kurse tani, mbas një viti, i «kishte plasur cipa» dhe i kishte thënë së jëmës: «...Unë nuk e marr atë burrë!...» Duke parë këmbënguljen e së bijës, që forcohej nga dita në ditë edhe plaka sikur po ndërronte mendje e jo vetëm që po binte dakord me të, por, me sa flitej, së fundi, ishte bërë shkaktarja kryesore që prishte punë.

Lefti, sa i kishte dëgjuar këto fjalë, kishte biseduar shumë herë me plakën, po ajo i qe përgjigjur sinqerisht:

— S'kam ç't'i bëj vajzës! Nuk do!...

Te kjo grindje ishte udhëzuar të kapej Ilka.

— Dëgjo mua: Mos ju ndaj! Është vajzë shumë e mirë. Pastaj është dhe turp të të ndajë femra, për nder!

— Po atë mendoj dhe unë, bre Ilkë.

— Ore po mos ju ndaj, për inat. Ajo shtrigë e jëma i bën të gjitha këto. Me sa më ka zënë veshi, do që ta martojë me atë Sulon, sekretarin e rinisë së fshatit.

— Si the, more?

— Mos u çudit! Kështu nën rrogoz bëhen këto punë. Ai i është qepur si rrodhe e do që t'ja marrë të bijën, se e di që ajo shtriga, plaka, ka flori. Që e ka ujdísur me plakën, për këtë ta besosh si buka që hëngre në drekë, por ç'do të bëjë vajza ajo është punë tjetër!..

— Edhe ajo më keq sillet.

— S'do mend. E shtyn shtriga!

— Ashtu duket!

— E di ç'ke ti, bre Lefti? Shkoi drejt e në shtëpinë e saj e shtrohu këmbëkryq. Shko mblidhja, or t'u mbylltë! Turp, bre, të të ndajë! Pse-o, ç'je ti, ndonjë fundërrinë, që të të bëjë leckë ajo çupërlinë?!

— Do të shkoj që flaka t'i bjerë — u përgjigj Lefti, të cilit i kërceu damari nga inati.

\* \* \*

«Thëngjilli» kishte detyrë tjetër. I nevojiteshin ndo njëzet kilogram mollë për t'ja dërguar një mik u andej nga një qytet bregdetar. Në pazar kish-te mollë sa të doje, por Xhelua donte mollë të mira... ashtu si për mik hesapi! Për këtë u ngrit e shkoi në fshatin e nuses së Leftit, ku njihte jo vetëm fshatin, por edhe shumë nga banorët e tij, se nga ato anë ishte edhe vetë, tjetër se tani banonte në qytet. U sorollat sa u sorollat tërë paraditen e më në fund ashtu si rastësisht, takoi me Hatixhenë, të vjehrrën e Leftit.

Fjala pruri fjalën e doli aty ku e priste Xhelua.

— Kur ke ndër mend që ta martosh vajzën —  
e ngacmoi ai me djallëzi.

— Kur do ta ndash, pse s'më pyet — tha pla-  
ka.

— Pse, moj?

— Se nuk u martoka vajza me zor, o Xhelo!

— Ashtu është! Kur nuk do vajza, mos e  
marto! Dëgjo, moj Hatixhe, meqë erdhi fjala, do  
të të them dhe unë nja dy llafe si motrës sime. Për  
besë, kur mora vesh se e fejove vajzën me atë nje-  
ri, nuk më erdhi hiç mirë! Bobo, Hatixheja e mori  
vajzën më qafë! Vajti e ja dha atij, që është sa ba-  
bai i saj, thash më vete!

— «Nëno, të dua e të respektoj, por unë nuk  
e marr atë që më ke fejuar!», ma ka prerë çupa.

— Mirë thotë. Në je e lojtur dhe ke vajzë të  
tepërt jepja! Pastaj kam dëgjuar se ai dhe pi!.. Ja,  
prite kur t'ja japin mandatën edhe nga ushtria! Hë,  
se m'u kujtua!... Do të të them edhe një gjë tjetër,  
se këtu s'na dëgjon njeri!

— Çfarë, more? — i tha Hatixheja, që ju af-  
rua më afër.

— Si të bëri zemra që dalldise të fejosh vajzën  
e vetme me një kaur, estakfurullah!

— More, për atë punë s'bëhem merak, se s'është  
të e para çupa ime që martohet me kaur, po ime  
bijë ma ka thënë copë: dashuron Malon, të birin e  
Meremes, që tani shkoi ushtar në kufi!..

— Malkën, traktoristin?.. Bravo i goftë! Shu-  
më, shumë djalë i mirë! Të trashëgohen! Dhe këtij  
tjetrit jepi duart. Ç'ma mban çupën akoma varur  
pas tij? Këto llafe s'janë dhe për të thënë, por unë  
do të t'i them! Kam dëgjuar se ai maskara ka shpi-



fur dhe njëmijë e një poshtërsira.. Jo se vajza jo-  
te bën dashuri tërë natën nëpër rrugët e fshatit  
me atë... Sulon, sekretarin e rinisë, jo se...

— U.. të më marrë të keqen e çupës!.. Veç  
mos ja pafsha surratin edepsëzit, pa ja rregulloj  
unë qejfin — u hodh përpjetë Hatixheja, që u skuq  
si spec nga inati?

Gjakrat e nxehtë. Të dy palët donin të shfry-  
nin dufin. Lefti, si u konsultua me Ilkën, një mbas-  
dite, u ngrit me biçikletë në fshat tek nusja, të ci-  
lën nuk e gjeti në shtëpi, se punonte në fushë. E  
vjehrra, që u ndodh vetëm, e priti shumë ftohtë.  
Ajo pritje dha shkak që biseda e tyre të merrte  
zjarr që në fillim. Inisiativën e mori ai që na ishte  
ofenduar më shumë.

— Unë e di përse po më pret kështu dhe nuk  
më do — i tha Lefti pa u ulur akoma në minder.

— Pse? — e pyeti buzëvarur Hatixheja.

— Se ti e do dhëndrin sekretar rinie — tha  
Lefti.

— U!.. M'u bëfsh kurban i vajzës! Ti të ma  
bësh mua çupën bushtër që bën dashuri tërë natën  
rrugëve të fshatit!.. Përjashta! Qëromu nga shtë-  
pia, se rrëmbeva drunë — e kërcënoi ajo.

Gjendja u ashpërsua shumë dhe asnjera palë  
nuk u nënështrua. Më në fund, u ndanë për të  
mos ja parë më kurrë surratin njëri-tjetrit!.. Grin-  
djen e tyre e mësuan shumë vetë.

Si u kthye në qytet, Lefti u takua me Ilkën, që  
e priste me padurim. Ja shpjegoi fill e për pe çfarë  
i kishte ngjarë. Nga mërzitja, të dy shkuan në pi-  
jetore, ku Lefti piu aq shumë, sa s'mbante mend se  
kush e shpuri dhe në shtëpi!

\* \* \*

Dy ditë mbas grindjes, ashtu sa kish perënduar dielli, Hatixheja na kishte qenë në pazar për të shitur ca fruta e po kthehej për në shtëpi. Ishte fare vetëm. Sa kaloi lumin, aty midis plepave të dendur, dy krisma të thata njëra mbas tjetrës e lanë të vdekur në vend.

Pse?.. Kush e bëri këtë krim?..

Njerëzit, organet e drejtësisë filluan të shqetësoheshin.

\* \* \*

Lefti kishte hallin e tij. Ju bënë dy ditë që kërkonte të kushëririn, Ilkën, dhe nuk po e gjente se «paskej shkuar me shërbim». Ai donte që ta takonte medoemos se kishte të nxehtë! Të nesërmen e natës që u deh, kuptoi se i kishte humbur revoi-veri! Po luante menç! Shpresonte se mos ja kishte marrë Ilka, prandaj donte ta takonte sa më parë. Atë mbrëmje i doli si «fandi spathi» aty para kinemasë. Krejt «rastësisht» në atë takim u ndodh dhe Xhelua, që u përçafua me Ilkën sikur të kishin vjete pa u parë me njëri tjetrin.

— Është një shoku im shumë i ngushtë — ja prezantoi ai Xhelon të kushëririn.

— Gëzohem që u njohëm — i tha Lefti Xhelos, pastaj ju kthye Ilkës. — Po ku drejtin ishe, se më ranë këmbët duke të të kërkuar.

— Hë! Ç'kemi, o kusho — pyeti Ilka me të qeshur.

— Hajde pak, se të kam një llaf — i tha Lefti,

e si kërkuan leje nga Xhelua, u larguan disa hapa më tej.

— Si e ke hallin? — e pyeti përsëri Ilka.

— Më humbi revolveri.

— Ikë more!

— Për besë se të gënjej! Mos ma more gjë ti parmbremë, që u deha, se s'mbaj mend fare?

— Jo, për kokën time! Pse, bëhen shakara me gjëra të tilla — i tha seriozisht Ilka — Dyshon tek unë?..

— Jo, bre, po thashë se mos ma more nga që isha i dehur — u përgjigj i pikëlluar Lefti.

S'kishin më se çfarë t'i thoshin njëri-tjetrit për këtë punë, prandaj u bashkuan prapë me Xhelon dhe të tre hynë në pijetore, ku pinë sa pinë e pastaj bënë nga një xhiro andej nga parku i qytetit. Ora kishte kaluar vonë. Njëpër park ishte errësirë e plotë. Aty ishte vendi më i përshtatshëm. Ilka ndërroi bisedë:

— Pse nuk erdhe ta merrje atë arkën që më porosite, o Xhelo — i tha ai.

— Do të kisha ardhur po isha në fshat; mora ato mollët që të kam thënë — u përgjigj Xhelua.

— Njëpër fshatra vërtet ka mollë të mira. Këto të pazarit s'bëjnë një grosh. Janë të kalbura, të vrra...

— E!.. Njëpër fshatra ka mollë të mira, por ka edhe qyfyre!.. E muarët vesh ç'kishte bërë vaki?..

— Jo! Çfarë ka ngjarë? — pyeti Ilka.

— Dje mbrëma paskeshin vranë një grua!.. E quanin Hatixhe... Hatixhe... Hatixhe Sefaj më duket!..

— Si the, e vranë? — pyeti Lefti i çuditur, që

ju duk sikur u zgjua nga ndonjë gjumë i rëndë, se mendja i punonte gjetkë.

— E vranë, e vranë, por se kush e përse ajo s'dihet!..

Lefti e humbi fare. Gjithfarë supozimesh i hipën në kokë. Fjalët i preu dhe shkante nga e shpinin këmbët.

— Po ti, nga dreqin e hape atë muhabet — e qortoi Ilka Xhelon me të vrazhdë.

— Pse, bëra keq? — e pyeti ai.

— Shumë keq bëre bile! Ajo që është vranë, ta marrësh vesh ti, është e vjehrra e këtij!..

— Mos, more! Qafsha të gjithë se e dija — tha Xhelua që bëri be e rrufe se nuk e dinte dhe i kërkoi të falur që ja tha ashtu pa takt atë lajm të hidhur. Leftit nuk ju dëgjua më zëri. U ulën mbi një stol guri dhe ndezën nga një cigare.

— Ç'më bëhesh merak shumë dhe ti, o Lefti. Shiko ore hallin tënd që të gjeti — i tha Ilka.

— Ç'është ky hall? — pyeti Xhelua.

— Lëre, lëre! I ka humbur revolveri!

— Revolveri? Për këtë bëhet merak? Hajde, more, se do t'i bëjmë derman dhe asaj pune!

— Do t'i bëjmë derman?! Si do t'i bëjmë derman, — pyeti Lefti.

— Merre më shtruar — e këshilloi Xhelua pa u nxituar — Kam gjetur unë një revolver oficeri.

— Ku e ke! Sille këtu!

— Meqë të ka humbur, besoj i yti duhet të jetë. Pa shikoje — i tha Xhelua duke i dhënë këllëfin bosh. Me ndihmën e çakmakut që ndezi, Lefti e njohu mallin e vet.

— Imi është! Sill dhe revolverin — tha ai.

— Ta jap unë, por prit, se të kam harxhuar nja dy fishekë — u përgjigj Xhelua si fajtor.

— Pse i ke harxhuar?

— Se vrava vjehrrën tënde Hatixhe Sefajn — tha Xhelua krejt i qetë.

Skena vërtet ishte tronditëse! Të dy agjentët qëndronin gati për çdo të papritur. Kishin kurdisur edhe planin që, po të mos u dilte ashtu siç dëshëronin, ahëre do ta vrisnin dhe mbi trupin e tij do të linin një shënim, ku të thuhej se vrasësi kishte marrë hakun e Hatixhesë. Lefti as që ishte në gjendje të kuptonte rrezikun. Ai shfryu me zemërim të papërmbajtur:

— Ti e vrave, i poshtër? Përpara! — i tha ai dhe e mbërtheu për xhakete Xhelon, që ja priti me ashpërsi:

— Ul zërin, se mos na dëgjojnë! Unë e vrava po revolverin ma dhe ti! Ti më the: «Shko vraje, se s'do të më japë vajzën!»

— Ç'janë këto shpifje, i poshtër!

— Ç'bëni kështu?! Mos bërtisni për këto gjëra, se do na dëgjojnë e do gjejmë belanë — ndërhyri Ilka.

— Hiqun mënjatë ti, se nuk më shpëton dot ky surrat — tha Lefti, që ishte bërë si i xhindosur.

— Ku do të më shpësh? — pyeti Xhelua.

— Në degën e punëve të brendshme.

— Meqë dashke, eja të shkojmë. Eja të shkojmë dhe do të shohim se kush do ta paguajë më shtrenjtë, unë apo ti — ja ktheu Xhelua, që i shtyu duart me nervozizëm.

— Ti, kriminel — tha Lefti.

— Veç spiunët si ti, zoti Lefti, që kanë hyrë me qëllime të caktuara në sigurim, dënohen më rëndë se sa unë, që kam bërë një krim ordiner.

— Unë spiun? Nuk më tremb dot, i poshtër!

— Nuk ta them për të të trembur, por them të vërtetën. Ti je agjent i vjetër i spiunazhit të huaj!

— Unë agjent i vjetër? Avash, se më gudulise — tha Lefti, që bëri sikur qeshi por që dridhej nga inati.

— Ti kujton se nuk kam fakte?

— Çfarë faktesh?!

— Prit se t'i kujtoj unë! Gjatë kohës së luftës, pa dalë partizan, kur punoje në terren, ti je plagosur në shpatull apo jo?

— Po, jam plagosur.

— Dhe je mjekuar në qytet në shtëpinë e doktor Kristofor Shikut, në mos gabohem?..

— Po! Ç'do të thuash me këtë?

— Asgjë! Veç desha të të bëj një pyetje — vijoi Xhelua, që po merrte në dorë frenat e situatës. — Pse pikërisht shkove në shtëpinë e tij dhe nuk shkove atje ku mjekoheshin edhe ilegalët e tjerë?

— Se atë e kisha shok!

— Mirëpo s'të beson njeri për këto që thua, zoti Lefti! S'ka se si të të besojë se, siç e di fort mirë, ai shoku yt Kristofor Shiku, ishte agjent i maskuar i gjermanëve, që u vu në veprim kur i erdhi koha nga një agjenturë tjetër. Më vjen keq që e pushkatuan, se do të të tregonte si të ka rekrutuar!

— Mua më ka rekrutuar?

— Po! Ke lëshuar dhe deklaratë!

— Deklaratë — bëlbëzoi Lefti, që nuk arriti ta

shqiptonte plotësisht fjalën, se filloi të kujtonte të kaluarën!..

... Vërtet ahëre kishte lëshuar një deklaratë... por, me sa i kujtohej atij... ja si kishte ndodhur:

«— Kjo drejtë plagë s'po më mbyllet! U mër-zita kështu shtrirë dhe mbyllur brenda katër mu-reve. Shokët po luftojnë! Do të ngrihem Kristofor — i kishte thënë ai doktorit që e mjekonte.

— Në asnjë mënyrë! Nuk të lëshoj! Ke nevojë të mjekohesh akoma — që përgjigjur doktori.

— Të falemnderit për shërbimin, por unë s'mund të qëndroj më këtu. Do të shkoj tek shokët, në mal!

Para kësaj këmbënguljeje, doktor Kristofori kishte pranuar me kusht: «Jemi shokë, Lefti, por do të më lëshosh një deklaratë se largohesh me dëshirën tënde që, po të të ndodhë gjë, të jem dhe unë i larë para nacionalçlirimtares» — kishte arë-syetuar ai.

Dhe Lefti kishte vënë firmën!.. Ja, kaq mbante mend!..»

— Jo!.. Këtu je gabim, zoti Lefti! Kristofor Shiku qëllimisht ta vononte mbylljen e plagës, që të vente puna tek deklarata. Që të jesh i qartë, ajo që ke firmosur, nuk ka qenë deklaratë e thjeshtë, por deklaratë që dëshmon se ti u vure në shërbim të spiunazhit të huaj. Mos harro se firma jote ru-het diku këtu afër! Kështu, pra! Tani, po deshe, eja shkojmë në degë — shfryu Xhelua.

Lefti mbeti si i hutuar.

— Prisni, more vëllezër! Daleni ta zgjidhim

me të mirë këtë punë — ndërhyri Ilka, që gjer ahere rrinte asnjëherë.

— Atë them dhe unë. Këto punë s'bëhen me të bërtitura. Ulu të merremi vesh, pastaj ti vepro si të duash — i tha Xhelua me një ton të zbutur. Lefti u bind se dhe Ilka ishte i një mendjeje.

Mbas kësaj, Xhelua, që zotëronte plotësisht gjendjen, ja numëroi Leftit me baza të gjitha rrezikët që e kërcënonin. I parashtrij planin si të vepronte që t'i largohej rrezikut. Ilka ishte plotësisht dakord me ato që thuheshin. Lefti e pa kurthin e rrezikshëm, por, kur ja treguan dhe fotokopjen e deklaratës me firmën e tij, ahere pranoi të vepronte siç i thanë. U përpëliti të kërkonte ndonjë sqarim më të hollësishëm rreth deklaratës, e cila e tronditi pa masë, por Xhelua ja preu shkurt hesapin:

— Për sonte mjafton me kaq! Tjetër herë do të kemi kohë të bisedojmë më shtruar dhe do të mësohesh gjithshka. Sidoqoftë ti mos u shqetëso, se s'ka për të të ndodhur asgjë!

Kështu u mbyll atë natë ajo ngjarje e rrezikshme, plot emocione dhe shqetësime!

\* \* \*

Mbas gjithë këtyre ngjarjeve, operacioni «Shigjeta në shenjë» përfundoi me sukses. Konkluzionet e arritura i dha «Akrepi» në mbledhjen e parë shumë sekrete, ku u shtruan udhëzimet dhe u përcaktuan detyrat aktuale. Këto detyra kërkonin: «... Të bënin për vete sa më shumë njerëz të pakënaqur nga pushteti, pasanikë të shpronësuar, persona



të dënuar për fajë politike!.. Të nxisnin arratisjet jashtë shtetit!..»

\* \* \*

Ditët e javët kalonin. Organizata antikomuniste vepronte nën rrogëz. Dy muaj e ca më vonë, mbas përpjekjesh sistematike, «Thëngjilli» mundi të rekrutonte dhe të përgatiste arratisjen e «Çap-kënit». Emrin e tij të vërtetë ky i fundit e kishte Asllan Shpata. Më parë kishte punuar në administratë andej nga kryeqyteti por si njeri i shtirë mbas vagabondllëqeve, na kishte bërë skandal me një femër dhe e kishin transferuar me ulje në një punë tjetër. I dëshpëruar nga dënimi, ai nuk ndenji në kryeqytet, por erdhi në qytetin e lindjes. Këtu u sorollat nja dy muaj nëpër rrugë, se nuk i jepnin punë për të qënë. Si e pa që nuk fitonte gjë me kokë-fortësinë e tij, ahëre u vendos në ndërmarrjen ku punonte dhe «Thëngjilli», të cilit qysh në fillim i tërhoqi vëmendjen ardhja e tij. Kishte kaluar një vit që punonin së bashku e djaloshi nuk kish-te hequr dorë nga huqet e tij. Në këto kushte, «Thëngjilli» e hetoi dhe, në përputhje me detyrat e reja, i hodhi grepin, e rekrutoi, dhe ai u arratis.

Kështu agjentët vepronin, por organizata priste nga «qendra» udhëzime të reja për ta zgjëruar aktivitetin e saj. Në këtë kohë u muar vesh se një diversant i nisur nga jashtë shtetit si ndërlihdës, që sillte këto udhëzime, ishte vrarë duke kaluar kufirin, prandaj duhej prituri!..

Në derën e zyrës u ndjenë disa trokitje të lehta.

— Hyrë — u dëgjua zëri i oficerit, që ishte përkulur e punonte në tavolinë. — Hë, ç'kemi, Qemal? — pyeti ai pa e kthyer kokën të shihte kolegë e tij, se e njohu nga të ecurit.

— Një radiogram, shoku Zisi — tha Qemali duke vendosur mbi tavolinë letrën që kishte në dorë.

— Nga vjen?..

— Nga Sokoli — tha Qemali. Oficeri tjetër lëshoi dokumentin që kishte në duar dhe mori me të shpejtë radiogramin, në të cilin ishin shënuar vetëm këto fjalë:

«Me vështirësi, por autorizimin për strehim e mora!» Të lumtë — tha Zisi i kënaqur duke përplasur dorën mbi tavolinë. Pastaj vijoi të lexonte. «Për ju jam në merak. Kam marrë vesh për gjarpërin poshtë vatrës! Koli.»

— Gjarpër poshtë vatrës?.. Ç'do të thotë kjo — pyeti Qemali i menduar.

— Do të thotë që «Sokoli» ka zbuluar se një agjent i maskuar i spiunazhit të huaj vepron këtu midis njerëzve tanë. Kjo duhet të zgjidhet sa më parë — tha Zisi. Dhe ashtu u bë: gjarpëri u zbulua! Për zbulimin e tij punoi me ngulm Zisi e kolegët e tij, por jo më pak për këtë gështje ndihmoi edhe «Sokoli», megjithëse ishte larg shtëpisë!

Kështu punët shkonin si jo më mirë!

Lefti Ngjelanit po i shkonte ters. Disa muaj mbas vrasjes së të vjehrës e përjashtuan nga Partia me motivacionin:

«... Me veset e tij të ulëta nuk meriton të mbajë titullin e lartë të anëtarit të Partisë!...»

E çmobilizuan nga ushtria, si njeri që me ato vese «njolloste figurën e oficerit të ushtrisë popullore!...»

Këto masa të drejta, e tërbuan fare Leftin. I fryrë dhe nga agjentët që e rrethonin, u mbush me një urrejtje të thellë për ata që «e kishin marrë nëpër këmbë dhe i kishin bërë tërë ato padrejtësira»! Për të gjitha këto ai desh të hakmerrej. Midis agjentëve i dukej sikur ndodhej midis njerëzve që e kuptonin. Në fillim vërtet e hëngrën ca me të pabesë, por pastaj ja kallëzuan të vërtetën hapur e me zemër në dorë. Edhe punën e revoles ja treguan. Atë ja kishte marrë i kushëriri, Ilka, e ja kishte dhënë Xhelos, i cili kishte vrarë Hatixhenë me «nagantin» që kishte marrë «hua» nga Llaqi e jo me revolen e Leftit. Po nuk qenë aq pa mend në kokë sa ta vrisnin me armën e këtij të fundit, se kjo do të ishte gjurmë, kurse Lefti u duhej ta ruanin, se e kishin «njeriun e tyre»! Kështu «Dhëndrri», siç e quanin ata, mbeti i paprekur.

Agjentët e parashikuan se me vrasjen e Hatixhesë, ai nuk do të arrestohej. Grindja me të vjehrrën vërtet ngjallte dyshime, por ato dyshime i hodhi poshtë vetë fakti që Lefti, atë mbasdite që u bë vrasja, vërtitej nëpër bulevardet e qytetit se

mos takonte Ilkën për punën e revoles, që i kishte humbur.

— Sigurimi do fakte e nuk shkon me supozime! Mos u bëni merak, se nuk do të pësojë asgjë — u tha shokëve «Akrepi» kur po kurdisnin planin në fjalë. Dhe vërtet ngjau ashtu siç parashikonte topalli, që fryhej si gjel deti sa herë e mburrnin për «zotësi».

Të gjitha këto suksese i formuan bindjen për suksesin e plotë të qëllimeve të tij. Veçanërisht shumë entuziazt ishte kur në një mbledhje i vuri në dijeni agjentët e tjerë se:

— ...Po vjen koha të realizojmë ëndrrat tona. Ne nuk jemi vetëm!.. Së shpejti do të ndërhyjnë nga jashtë me ushtritë e tyre aleatët tanë!.. Që të dalim ballëlartë kur të çlirohemi, edhe ne duhet të veprojmë!...»

— Shumë e drejtë! Mjaft nderjëm duarkryq! Të fillojmë nga aksionet. Unë mendoj që herën e parë të qërojmë ndonjë nga udhëheqësit e këtushëm — propozoi «Dhëndrri».

— Mos u nxito — e këshilloi topalli, të cilit ju bë qejfi për ato fjalë — Ashtu do të bëjmë, por më parë duhet të përgatitemi mirë! Të përgatitemi, se ky do të jetë vetëm fillimi i përpjekjes së ashpër!

\* \* \*

Oficer Zisi mendonte ndryshe, atë çast kur u ngrit dhe po vishte gëzofin. Ai mendonte se po afrohej fundi i këtij lëmshi, që zgjati si tepër. Shumë

ujë kishte rrjedhur që nga ajo ditë kur nisën këto ngjarje të komplikuar.

— Çdo gjë është gati — raportuan dy oficerët që ju paraqitën në zyrë.

— Shkojmë, shokë — tha ai, si e kishte veshur gëzofin dhe të tre zbritën shkallët e ndërtesës dykatëshe. Jashtë kishte rënë errësirë e plotë, por ajo ishte një natë e bukur. Mbi kupën e qiellit vezullo- nin yjet plot shkëlqim.

— Në një natë të tillë edhe pse bën ftohtë, udhëtimi është i këndshëm — tha oficer Zisi duke hipur në maqinë.

— Bile shumë interesant — shtoi kolegu, që zuri vend në krah të tij. Mbas kësaj bisede të shkurtër, s'dëgjohej gjë tjetër veç zhurmës monotone të motorit të «gazit 69» që, sa doli nga qyteti, me drita të shojtura, filloi të rrëshqiste mbi rrugën e asfaltuar!

\* \* \*

Atë mbrëmje dhjetori, agjentët, me fshehtësinë më të madhe, u mbledhën në bodrumin e një shtëpie diku mjaft larg qytetit. Ishte një mbledhje me rëndësi, që pritej me padurim. Në të merite pjesë edhe «Çapkëni», që ishte arratisur jashtë shtetit kohë më parë. I ardhur si diversant, ai kishte sjellë porosira të rëndësishme nga «Qendra». Mbi të gjitha, këtu qëndronte dhe vlera e takimit të agjentëve, fytyrat e të cilëve mezi dalloheshin në dritën e zbehtë të fenerit që ishte vendosur mbi arkën bosh. Rreth asaj arke kishin zënë vend pjesëmarrësit e mbledhjes. Në krye qëndronte «Akrepi», kurse nga

fundi, në hyrje, aty pranë derës, me automatik në dorë kishte zënë vend «Çapkëni».

Diskutuan me radhë. Raportoi secili për aktivitetin e tij, por të gjithë shfaqën të njëjtin shqetësim:

«E kemi vështirë! Siç po bëhet, s'merret vesh se kush është popull e kush është komunist e i sigurimit!..»

U rrahën mendime e u thanë shumë gjëra, që më parë nuk diheshin nga të gjithë. Së fundi i erdhi radha «Çapkënit», të dërguarit të posaçëm të «Qendrës». Ai u ngrit në këmbë, rregulloi bluzën kaki që kishte veshur dhe, si u kollit pak që t'i çelëj zëri, filloi të fliste rëndë-rëndë:

— Zotërinj! Ju dëgjova me vëmendje të madhe. Që prej fillimit të aktivitetit tuaj e deri më sot kanë kaluar vjete. Në tërë këtë kohë të gjatë, ju shpeshherë e kini pasur vështirë, por prapë këni punuar e s'keni qëndruar duarkryq. Për të gjithë veprimtarinë tuaj «Qendra» është plotësisht në dijeni dhe ju ka ndjekur hap mbas hapi!

Pak më parë, këtu dikush nga ju tha: «Ka ardhur koha që ta marrë fjalën plumbi!» E drejtë! Shumë e drejtë! Edhe shokët e «Qendrës» të atij mendimi janë. Mjaft më! I erdhi radha automatikut — tha ai dhe me të dy duart mbërtheu armën sikur do të nisej për sulm. Pjesëmarrësit e mbledhjes, që dëgjonin në heshtje, aprovuan fjalët e tij. «Çapkëni» vijoi të fliste:

— Pra, në përfundim, po ju njoftoj se me vendim të «Qendrës», për tradhëti të lartë...

— Midis nesh nuk ka tradhëtarë! Ndërlidhësin

që u vra në kufi nuk e ka tradhëtuar njeri — ndërhyri «Akrepit».

— Dëgjo — e ndërpreu «Çapkëni» — Për tradhëti të lartë ndaj atdheut, fjalën po ja jap automatikut! Duart lart, tradhëtarë! — bërtiti ai me sa fuqi që kishte.

Agjentët u tmerruan nga e papritura.

— Asllan, Asllan... E ke gabim — u hodh Xhelua, që bëri të ngrihet nga vendi.

— Mos lëviz, se t'i derdha trutë! Të gjithë do të jepni llogari përpara «Qendrës» — tha «Çapkëni», që rrinte gati me gishtin në këmzën e shkrehjes së automatikut.

Akoma nuk kishte mbaruar fjalën e fundit, kur dera u hap me rrëmbim dhe në bodrum u dhanë tre përfaqësuesit e «Qendrës» Zisi dhe dy oficerët e tjerë.

— Të lumtë, Asllan! E meritove plotësisht emrin e «Sokolit» — i tha Zisi atij që me automatikun në dorë vuri buzën pak në gaz, por nuk lëvizi nga vendi.

Spiunët u ngurosën të llahtaritur. Atë çast Llaqi kujtoi historinë e fatit të akrepit, emrin e të cilit mbante pseudonim. Këtë histori qëllimisht ja kishte treguar «Profesori». Simbas asaj akrepi, kur shikon se rrethohet nga zjarri e s'ka shpëtim, vret veten!

Kështu do të kishte bërë dhe Llaqi me agjentët e tjerë, por rrethi i kuq ku ndodhej nuk i lejoi «akrepit».

## OPERACIONI I NJË PLAGE TË VJETËR

Pllaja e malit nëpër të cilën gjarpëronte rruga e re automobilistike, ishte mbuluar nga një mjegull aq e dendur, sa që nuk të lejonte të shikoje më shumë se dy tre metra larg. Nga kjo shoferi i «gazit 69», jo vetëm që drejtonte timonin me shumë kujdes e herë mbas here shkelte pedalin e frenave, por u detyrua të ndizte dhe dritat për të dalluar vendin.

— Rrugë e vështirë — tha shoferi.

— Mjegulla po e vështirëson edhe më shumë — shtoi oficeri operativ, që ndodhej në krah të tij. Në këto e sipër, aty në përrua, maqina frenoi para një guri të madh, që kishte rënë nga sipër.

— Edhe këta dreq gurësh sot nuk na lanë rehat! Ta hajë dreqi, ta hajë — tha nëpër dhëmbë shoferi. Oficeri nuk ju përgjegj, por doli mbas tij dhe të dy e larguan gurin në hendek.

— Na e sollën në majë të hundës këto pengesa, shoku Engjëll — tha përsëri shoferi, që vuri në lëvizje «gazin» i cili ngadalë filloi të zbriste tatë-pjetë.

— Megjithatë s'janë në gjendje që të na ndalojnë — ju përgjigj me të qeshur punëtori operativ,



që e kishte ngulur vështrimin e tij përpara, te dritat e forta që çanin mjegullën e dendur.

Edhe mbas një çerek ore, kur maqina zbriti në asfalt e po i afrohej me shpejtësi qytetit, oficeri akoma vazhdonte t'i kishte parasysh pengesat që u kapërxyen gjatë asaj rruge të rrezikshme. Kjo e bëri që ato pengesa t'i krahasonte me vështirësitë e detyrës për të cilën e kishte marrë atë udhëtim.

Ky ishte vetëm një krahasim figurativ, se as që mund të vihej në balancë me atë detyrë të ndërlikuar që duhej të kryente.

\* \* \*

Për ta kuptuar këtë do të kthehemi disa vite më prapa, në ditët e shtatorit të 194...

Propozimi për të formuar kooperativën bujqësore, kishte ngjallur biseda të zjarrta në banorët e fshatit të largët kufitar. Për ngritjen e saj ishin interesuar të gjithë, mirëpo ja që kishte ndonjë aty-këtu, që lëkundej e sillte pengesa.

— Kooperativën do ta ngrejme edhe pse ka ndonjë që akoma nuk e kupton se ajo është për të mirën e tij — u thosh Tafil Aldushi bashkëfshatarëve, që ishin mbledhur atë mëngjez e po diskutonin për këtë çështje. Ai ishte vërtetë një përkrahës i zjarrtë i krijimit të kooperativës. Ta vuri përpara dhe e bëri për pesë para njërin nga ata që s'donte të bashkohej, megjithëse s'kishte më shumë se një këndez plaçka dhe dy dylmë tokë! Kishte akoma për t'i thënë, por e ndërpreu një fëmijë, që i erdhi pranë me të rendur dhe i tha:

— Xha Tafil! Kau i Tulçakëve ka hyrë në bahçen' tënde dhe po bën batërdinë!

— Ej! Ç'më polli belaja me atë njeri — tha i inatosur Tafil, që e la llafin në mes dhe rendi me vrap andej nga arat. Si dëboi kaun nga bahçeja, u kthye i xhindosur, se vërtet i qe bërë dëm i madh në pemët dhe të mbjellat!

— Do ta detyroj të paguajë dëmin! Shumë e ka lëshuar kapistallin ai Sabri Tulçaku! Para ca ditësh, dhitë e tij më bënë dëm në bahçe, sot kau!.. Të paguajë dëmin e të mbledhë mendjen e kokës! Në është anëtar këshilli, qoftë shëndoshë! Të bëjë zap kafshët e bagëtinë dhe të mos i lëshojë si në mall pa zot — shfryu i zemëruar ai para fshatarëve. Kishte vendosur që atë mbrëmje ta thërriste Sabri Tulçakun e t'i kërkonte hesap, por ai i erdhi vetë pa e thërritur dhe u takuan mu në mes të fshatit. Që nga larg dukej që edhe Sabriu ishte tërë inat.

— Ku je, more Tafil trimi? — i tha ai.

— Trim dhe kapadai je ti, që lëshon bagëtinë e kafshët në mallin e botës si në mallin tënd dhe nuk vjen të kërkosh të falur — ju përgjegj Tafil, të cilit nisi t'i kërcente damari.

— Trima janë ata që vrasin! Në qoftë se të bëri dëm kau im, jam gati të t'i paguaj paratë!...

— Siç më pagove radhën e parë për dëmin që më bënë dhitë e tua — tha me ironi Tafil.

— Prandaj m'i theve këmbën kaut, more edep-sëz?! E di ti se unë atë e kam kaun e parmendës?!

— Mbaje gojën e mos shaj! Unë nuk i kam thyer këmbën kaut tënd — ju përgjigj Tafil.

— Ti që e nxore jashtë nga bahçeja m'ja theve,

kush tjetër! Dëgjo këtu, o Tafil Aldushi; Ose do të më paguash kaun gjer më një, ose bashkë s'ndahe-mi mirë!

Kështu plasi sherri. Sabri Tulçaku kërkonte me këmbëngulje t'i paguhej vlera e kaut, kurse Tafil Aldushi, që nuk e quante veten fajtor për këtë, desh shpërblimin e dëmit që i qe bërë. Gjendja u ashpërsua aq shumë sa që në gjaknxehetësi e sipër Sabriu goditi me pëllëmbë Tafilin. Fshatarët që u ndodhën aty, ndërhyjnë dhe i ndanë, se puna do të kishte përfunduar keq. Por ajo që nuk ndodhi atë mbrëmje, ngjau katër ditë më vonë.

Afër darkës, në të dalë të fshatit. Sabri Tulçaku, që kthehej nga puna, mbeti i vrarë nga plumbi i një krisme të vetme. Në fshat u dha kuja e alarmi. Njerëzit shkuan me nxitim në vendin e ngjarjes por nuk gjetën asnjë gjurmë të vrasësit. Megjithatë e muarën me mend se kush mund të ishte autori ose nxitësi i krimit.

Të nesërmen e asaj rrëmuje, vëllai i Sabri Tulçakut, për të marrë hakë, qëlloi me sopatë dhe la të vdekur në vend Tafil Aldushin!...

Kështu ndodhën dy krime njëri mbas tjetrit. Ato shkaktuan dhembje të madhe në familjet dhe të afërmit e viktimave, por sollën dhe përçarje në tërë fshatin, ku njerëzit ishin lidhur me gjini njëri mbas tjetrit. Kjo ndodhte pikërisht ahëre kur në rend të ditës shtrohej çështja e bashkimit në kooperative.

Nuk mbaroi me kaq!

Fare pak ditë më vonë, një ngjarje tjetër tronditi tërë fshatin. Papritur u përhap lajmi i vdekjes së Dhimitrullës, së shoqes së Petraç Gangos. Dhi-

mitrulla ishte një grua nikoqire dhe e zonja e punës. «Punonte sa për shtatë!» thoshin fshatarët, prandaj e donin të gjithë. E donin, se s'kursehej jo vetëm për punët e saj, por edhe për punët e fshatit. Nga kjo, atë mëngjez, kur e muarën vesh, të gjithë u pikëlluan sa s'kish ku të vinte. Natyrisht, më shumë se këdo tjetër, vdekja e saj hidhëroi të shoqin, që i la katër fëmijë jetimë. Por njerëzit, sa ndjenë për të keqardhje, aq më shumë u habitën nga vdekja e saj e papritur.

Ç't'i bësh! Në jetë gjithshka ndodh!

I shoqi dhe ndonjë tjetër mbas tij, as që merrnin vesh fare nga mjekësia, por e morën me mend nga se mund të kishte ardhur vdekja e saj.

— Si e pati, e gjora, o Petraq? — e pyesnin fshatarët të shoqin kur e ngushëllonin.

— Po si t'ju them dhe unë i ngrati! Si duket nga zemra! Më kishte thënë disa herë se ndjente dhembje në zemër, por unë nuk ja vura veshin fjalëve të saj, dhe moskokëçarjen time e pagova shtrenjtë, or vëllezër e motrani — u përgjegjej ai.

— Nga zemra! Nga zemra vdes ashtu pup e pup!

— Po ç'është njeriu, a derëbardhë, dhe ju! Top llastiku është! Po u shpua.. mbaroi!

— Vdekjen e kemi prapa veshit! Vetëm asaj nuk i dihet se kur të vjen!..

— Të bëri gjëmën që të vdiq! Të rros vetë me fëmijë — e ngushëllonin bashkëfshatarët Petraqin, që ishte bërë pikë e vrer e nganjëherë nuk i mbaheshin dhe lotët. Mundohej që ata lot të mos binin në sy të të tjerëve, por prapë nuk e mbante dot veten. Në ato anë, burrat e kishin për turp të

qanin, por Petraqit i falej dhe i jepnin të drejtë. E kishte pllakosur një hata e madhe. Me atë grua, që kurrë nuk ja bëri fjalën dysh, kishte ndarë gëzime e hidhërimë, kishin kaluar një jetë të tërë, kishte katër fëmijë si pëllumba!

Eh!.. Sidoqoftë, njeriu në jetë duhet të bëhet i fortë e i duruar! Kështu bëri dhe i gjori Petraq: Varrosi të shoqen dhe zemrës i vuri një gur!..

\* \* \*

Këto ishin të dhënat fillestare të atyre ngjarjeve tragjike. Duke bërë vlerësimin për secilën, vrasjet meritonin vëmendjen kryesore, për arsye se ato kishin goditur në një pikë delikate, në unitetin e popullit, që shtrohej me forcë.

Ç'i do fjalët! Me dashje ose pa dashje, vrasjet shpunë ujë në mullirin e armikut — thoshin shumë vetë.

Megjithëse rrjedhimi i tyre nuk linte dyshime për ekzistencën e veprimtarisë armiqësore, ata që vigjëlonin nuk e lanë punën në heshtje por këmbëngulën për t'u siguruar.

«Këto mund të zbulohen duke kërkuar shkaqet e rrjedhimin e hollësishëm të ngjarjeve» mendonte Engjëlli, punëtori operativ, që këtu vërtet ndodhej para një ekuacioni me shumë të panjohura.

Rrjedhim i hollësishëm i ngjarjeve!..

Engjëlli do t'i njihte shumë shpejt ato sikur të kishte mundësi të nxirrte të dhëna nga vetë autorët kryesorë të ngjarjes: Sabri Tulçaku e Tafil Aldushi, por, siç dihej, ata nuk jetonin. Kjo ja vështi-

rësoi kryerjen e detyrës, po ai nuk u ndal. Gjeti të tjera burime. Shumë persona dhanë ndihmën e tyre!

«... Sabri Tulçaku rridhte nga një familje e mesme e nuk ka qenë keq nga gjendja ekonomike, po ta krahasoje me të tjerët në fshat. Si gjatë luftës edhe më pas ka mbajtur qëndrim të mirë. Djalin e tij të madh ja kanë vrarë fashistët italianë më 1943, në një demonstratë që u bë në qytet!.. Mbahej pak si kapadai, por nga zemra ishte i mirë. Vetëm në kooperativë s'desh të hynte!

«Hë për hë, hyni ju një herë, pastaj do të shoh e do të bëj dhe unë» — thoshte ai.»

«Po Tafil Aldushi?..»

«... S'kemi seç të themi për të! Familja më e këputur e fshatit ka qenë. Ishte i pari që përfitoi tokë nga reforma agrare. I lidhur me Partinë si mishi me koskën, që kur kërciti dyfeku. Edhe vetë ka qenë partizan. Ç'është e vërteta gjaknxehtë ka qenë, por në të drejtë, ama! Copë bëhej për fshatin!... Kishim menduar ta propozonim për kryetar të kooperativës që do formohej, por ç'e do!.. Ngjau ajo që ngjau!..

«Cili të ishte shkaku i vërtetë i grindjes?»

«... Unë isha vetë aty dhe çdo gjë e pashë me këta sy! U grindën për punën e kaut! Sabriu i nxehur e goditi me pëllëmbë... Tafili, si duket, u turpërua në mes të fshatit dhe bëri atë që bëri!..»

«Ishin grindur tjetër herë?..»

«...Nëpër mbledhje ishin grindur për punë të kooperativës. Shumë herë Tafili e kishte kritikuar Sabrinë se, duke mos hyrë vetë, pengonte dhe të afërmit e tij, që përbënin më shumë se gjysmën e

fshatit. Sidoqoftë, megjithëse ishin grindur, është për t'u çuditur se si arriti puna gjer në vrasje!..»

Këto të dhëna të dokumentuara jepnin një tablo pak a shumë të qartë të gjendjes.

Sabri Tulçaku e Tafil Aldushi ishin dy njerëz të mirë, që kishin rënë viktimë e një mosmarrëveshjeje që mund të zgjidhej.

«Vetëm një gjë nuk po kuptoj — mendonte punëtori operativ — pse Tafil Aldushi, pasi vrau ose nxiti vrasjen e Sabriut, nuk u mbrojt, por të nesërmen doli fare pa drojtje?..»

«Mos donte të tregonte se nuk ishte ai vrasësi? ... Apo me të vërtetë ishte i pafajshëm?..»

Para kësaj pyetjeje gjurmimi u bllokua dhe perspektivat për të hedhur dritë mbi të vërtetën ishin të pakta.

\* \* \*

Po për vdekjen e papritur të Dhimitrulla Gango ç'ishte bërë?.. Në këtë drejtim gjurmimi ecte ngadalë po me sukses. Të nisur nga fakti që njeriu nuk vdes pa një shkak, i cili duhet të jetë i dokumentuar, organet e hetuesisë, vazhdonin kërkimet.

Duke verifikuar edhe një herë të dhënat e mbledhura fill mbas asaj ndodhie, Engjëlli bëri takim me atë që kishte dhënë një sqarim «kompetent»!

— Dëshëm t'ju pyesim edhe një herë — tha punëtori operativ — ju e keni lëshuar këtë deklaratë zyrtare ku vërtetoni se «Dhimitrulla Gango ka vdekur nga pushim zemre?..»

— Po, unë e kam lëshuar! — u përgjegj ai duke përpëlitur kapakët e syve poshtë gjyslykëve.

— Jeni i sigurt për këto që shënoni në deklaratë?

— Unë kam thënë në deklaratë ato që kam dëgjuar.

— Domethënë ke shënuar ato që ke dëgjuar e nuk je mbështetur mbi ndonjë dokument?

— Ashtu është! Kam thënë ato që kam dëgjuar.

— Më falni, por ligjet tona nuk mbështeten në fjalë në erë por në fakte. Ju përfaqësonit pushtetin në atë kohë, prandaj s'duhej ta kishit vënë firmën dhe vulën mbi një deklaratë të tillë pa praninë e mjekut!

— Keni shumë të drejtë, mor shok, po mua aq ma preu! [E shoh që e kam shkelur — tha burri i moshuar duke ulur kokën.

Megjithëse nuk dihej saktësia e dokumentit, ky vërtetim që dukur sikur i kishte vënë kapak çështjes, por zbuluesit e së vërtetës vazhduan punën e tyre. Ata gjithmonë dyshonin se në atë mes kishte diçka që nuk shkonte!

Edhe në bisedat midis fshatarëve filloi të ringjallej interesi për të mësuar të vërtetën rreth asaj vdekjeje gati misterioze.

— Si vdiq ajo grua ashtu, fare papritur?!

Ndokujt kjo pyetje mund t'i dukej e kotë dhe të të jepte përgjigjen aty për aty:

— Vdiq se aq e pati! Ç'kërkoni tjetër! Të gjithë do të vdesim.

Ky justifikim mund të vinte në gjumë vetëm naivët.



— Në qoftë se njeriu vdes, duhet të ketë qenë sëmurë. — thoshte dikush nga fshatarët.

— Po, sëmurë ishte! — i përgjigjej një i dytë.

— Jo, mor vëlla — deklaroi një grua — unë e kam patur shoqe të ngushtë e kurrë s'më kishte thënë se vuante nga ndonjë sëmundje.

— Po ç'sëmurë, mor të uruar! Ajo ishte ta çaje e ta bëje katër, që thonë! Pastaj më kujtohet shumë mirë, një ditë para se të vdiste e pashë me këta sy: punoi në arë jo më pak se dhe herët e tjera — kishte shtuar një tjetër.

— Ashtu është, po mos harroni se vdiq nga pushim zemre! Kur vdes njeriu nga një sëmundje e tillë, nuk lëngon fare. S'pyet zemra se je i dobët apo i shëndoshë! — thoshte dikush tjetër.

Kjo e detyroi punëtorin operativ të kthehej mbrapa në kohë dhe të mblidhte të dhëna për të rikujtuar ditën e vdekjes së Dhimitrullës.

«I shoqi dhe katër fëmijët, që e kishin rrethuar, qanin për të sa të këpusnin shpirtin. Ata kolo-puçë donin të shmallehin për të fundit herë me nënën e tyre të dashur, dukej sikur donin ta pyetnin, ta qortonin që i la aq të vegjël, por ajo qëndronte e heshtur në arkivol.»

«E kishin veshur si nuse!». . . Fytyrën ja kishin mbuluar!... E ç'ti kujtoje më parë! Këto mbanin mend njerëzia!

«Fytyrën ja kishin mbuluar?»

«Pse?»

«Thanë se ishte prishur shumë në fytyrë dhe nuk bënte që ta shikonin fëmijët.»

«Ashtu, ashtu prishet njeriu kur vdes nga zemra!»

«Unë desha që ta zbuloja e të përshëndetesh me të ndjerën Dhimitrullë, siç e kemi zakon nga ana jonë, por nuk më lanë, moj motër» tha një grua.

«Hë, moj dhe ti, ç'na i hap ato plagë» e kishte qortuar një shoqja e saj. Ky fakt e bëri punëtorin operativ të mendohej.

«Për ç'arësye nuk e lanë atë grua që të shikon-te fytyrën e së vdekurës? Mos vallë se në fytyrën e saj dalloheshin gjurmët e krimet?...»

Kjo pyetje donte shpjegime! Pa shumë telashe kjo punë mund të ishte sqaruar dy vjet më parë, po të qe bërë autopsia e së vdekurës, por tani ishte shumë vonë. Kufoma e saj ishte tretur me kohë. Kjo ishte një vështirësi serioze.

Ç'duhej bërë? Të mjaftohej me kaq?

«Jo! Vështirësitë duhen kaluar. Kur mbyllet një shteg, duhet gjetur një tjetër» mendonte Engjëlli.

Gjatë procesit të punës, ai argumentoi përfundimisht se kufomën e kishin mbajtur në shtëpi vetëm pak orë pas vdekjes. Ajo kishte vdekur aty nga mezi natës dhe e kishin varrosur të nesërmen rreth orës dhjetë!

— Pse e varrosën kaq shpejt? — pyeti shefi, kur ishte duke biseduar me punëtorin operativ rreth këtyre ngjarjeve.

— Thanë se po ta mbanin më shumë, do të mbante erë. Kjo i paskish detyruar jo vetëm ta spërkatin me livando por edhe ta varrosnin shpejt e të mos prisnin sa t'i vinin prindërit e saj andej nga një fshat i rrëzës! — ju përgjegj Engjëlli.

— Ashtu?

— Edhe këtu ka diçka që nuk shkon! Vdekja

e saj e papritur. Fytyra e mbuluar! Varrimi i shpejtë!.. Të gjitha këto, siç duket, janë veprime për të mbuluar krimin — tha i vendosur punëtori operativ.

— Keni plotësisht të drejtë! S'mbetet gjë tjetër, veç t'ju referohemi fakteve për t'u bindur se sa i saktë është kokluzioni ynë — përfundoi shefi.

Drejtësinë e atyre konkluzioneve e argumentoi ekspertiza. Me kujdes u hap varri i Dhimitrullës. Kufoma e saj ishte dekompozuar plotësisht, por në mbeturinat e trupit u gjetën të dhëna me vlerë: «Një solucion helmi me bazë zhive kishte shkaktuar vdekjen e saj»!.. U vërtetua me baza shkencore se aty kishte një krim! Me këtë nuk mbetej gjë tjetër, veç të gjendej dhe krimineli. Kjo ishte një vështirësi jo më pak serioze se e para!

Kush mund të ishte ai që kishte kryer atë krim?

Për këtë Engjëlli punoi ditë e natë. Ai donte që sa më parë ta zbulonte kriminelin. Ta zbulonte atë zëmërgur që pati guximin të vriste një nënë që la jetimë katër fëmijë! Nuk i kishte rënë rasti t'i shikonte veç një herë ata fatkeqë, por i parafytyronte se si rrinin kokulur dhe i vinte keq. Sa herë që i kujtonte, i dukej sikur dëgjonte thirrjen e tyre lutëse:

«Gjëje atë që na vrau nënën dhe na la jetimë!..»

Dhe punëtori operativ punoi me ndërgjegje të lartë për ta çuar në vënd lutjen e tyre. Nuk kurseu asgjë për të zbuluar kriminelin, që drejtësia popullore t'i jepte ndëshkimin e merituar!

\* \* \*

Zbulimi dhe ndëshkimi i kriminelit, natyrisht u takonte organeve të drejtësisë. Meqenëse në atë vdekje u vërtetua krim, ato duhej ta shpinin çështjen gjer në fund, ndërsa Petraq Gangos që i kish ndodhur fatkeqësia, as që i binte të merrej me atë punë. Një mbrëmje, mjaft kohë pas vdekjes së Dhimitrullës, Petraqi që pas një viti e ca pothuajse e kishte harruar fare gruan e tij, Dhimitrullën, u ndodh para së papriturës: atë natë gjithë fshati mori vesh se kush ishte krimineli që i shkaktoi vdekjen së shoqes.

— Në emër të ligjit, je i arrestuar Petraq Gangua — i tha punëtori operativ me një ton të prerë e të ashpër.

Ai u bë dyll i verdhë dhe filloi të dridhej si purteka në rrymën e lumit. Njerëzit deshën të dinin arësyet e arrestimit të tij.

— Keni për ta marrë vesh — u tha fshatarëve oficeri duke vënë përpara Petraq Gangon, që filloi të ecte si i dehur.

\* \* \*

Para gjyqit të popullit çdo gjë do të dilte e qartë brenda disa seancave, kurse Engjëllit ju desh një punë e gjatë dhe e komplikuar për të arritur në përfundimin që Petraq Gangua ishte krimineli, vrasës i së shoqes.

Si u zbulua krimi i tij?

Lotët e korkodilit që derdhi atë ditë kur «i vdiq» e shoqja, nuk ja arritën plotësisht qëllimit, ashtu siç mendoi Petraqi. Jo të gjithë u besuan fjalëve se «Dhimitrulla vdiq nga pushim zemre». Po kështu, mbi të rëndonte edhe dyshimi i mbulimit të fytyrës së kufomës dhe varrosja e saj e shpejt e shpejt!

— Patjetër ka diçka që ja kanë mbuluar fytyrën e nuk të lënë ta zbulosh — thoshin njerëzia vesh më vesh.

— Në qoftë se është kështu, ahëre nuk ka se si të mos ketë dijeni dhe Petraqi — plotësonin të tjerët.

«Kështu, vigjelon dhe populli» — mendonte Engjëlli sa herë i binin në dorë të dhëna të tilla që plotësonin njëra-tjetrën.

Edhe diçka tjetër mjaft e rëndësishme ndihmoi në zbulimin e autorit të krimin. U vërtetua plotësisht se doza e helmit të përdorur kishte një forcë të menjëhershme veprimi. Kjo do të thoshte se Dhimitrulla kishte vdekur brenda jo më shumë se tridhjetë minutave pasi kishte pirë helmin! Lindi pyetja: «Kush qe pranë saj brenda orëve?..»

Këtë e dinin të gjithë! Petraqi ishte me të në shtëpi, përveç fëmijëve, për të cilët s'mund të dyshohej. Këtë gjë Petraqi nuk e kundërshtonte as vetë!

Mos ndoshta Dhimitrulla kishte helmuar veten?

— I shoqi nuk tha asgjë! Po të diktonte një gjë të tillë, pse të mos njoftonte menjëherë? Apo nuk e ka diktuar?.. Jo! Helmimi gjithmonë sjell dhembje e lë shenja që vështirë t'i mbulosh!

Kështu, të gjitha dyshimet u kristalizuan dhe

Petraç Gangua u vu në bangon e të akuzuarve për të dhënë llogari!

\* \* \*

— Me arrestimin e Petraçit dhe të dhënat e mbledhura për të, ç'mendoni për kompleksin e ngjarjeve? — pyeti shefi i degës.

— Helmimi i Dhimitrullës disa ditë mbas vrasjeve dhe shqetësimi i saj, që ishte vënë re mbas këtyre gjer sa jetoi, më bën të dyshoj se tek ky njeri kemi gjetur çelësin për të zbuluar të vërtetën e gjithë shqetësimeve — u përgjegj punëtori operativ.

— Nuk mendoni keq. Veç kujdes! Keni të bëni me një person shumë të djallëzuar, që ka ditur të maskohet me mjeshtëri. Së bashku me tradhëtarë të tjerë, kur po çlirohej vendi, u arratis jashtë shtetit. Është rikthyer kur mësoi se përfitonte nga amnistia. U largua nga krahina e vendlindjes dhe u martua në atë fshat kufitar. Të gjitha këto lënë për të dyshuar! Mos ndoshta këtë e ka bërë për qëllime të caktuara?..

— Si urdhëron, e kam parasysh — tha punëtori operativ që, disa ditë më vonë, provoi se sa të drejta ishin dyshimet e shefit të tij.

\* \* \*

— ... Po ju them se më keni arrestuar gabim — ngulte këmbë Petraçi. Engjëlli, që kishte radhi-

tur e kishte menduar çdo gjë, nuk u nxitua t'i përgjigjej. E pyeti i qetë vetëm pasi shojti bishtin e cigares.

— Urdhëro shikoi! Këto janë rezultatet e analizave laboratorike, që vërtetojnë se gruaja juaj ka vdekur nga helmimi. Ja dhe ngjyra që ka pasur helmi — i tha ai dhe i tregoi një shishe peniciline me një lëng ngjyrë gri.

Petraçi u gëlltit dhe s'guxoi të kundërshtonte.

— Që ti je autori i krimit, këtë nuk e mohon dot, se kemi dhe dokumenta të tjera që e vërtetojnë — vijoi oficeri që i radhiti një sërë faktesh të pakundërshtueshme, të cilat e shtrënguan të pranonte akuzën. Me këtë, Petraq Gangua mendonte se do t'i jepte fund me kaq: «Do të përgjigjej para ligjit për vrasjen e së shoqes, e mbaroi», por punëtori operativ vazhdoi pyetjet:

— Pse ishte e shqetësuar gruaja juaj fill mbas vrasjes së Sabri Tulçakut e të Tafil Aldushit?...

— Pse e helmova mbas këtyre vrasjeve e jo më parë?...

— Na thuaj, ku e gjete helmin?..

Këtyre pyetjeve i akuzuari u mundua t'u shmangej, por kur pa se s'kishte nga t'ja mbante u përgjegj:

— Helmin ma dha «Xhindi».

**Pyetjet e bëra dhe përgjegjia e dhënë shënoi fillimin e zgjidhjes së të panjohurave!**

Petraçi Gangua nisi të përshkruante kush ishte «Xhindi», lidhjet që kishte patur me të dhe tërë zhvillimin e ngjarjes.

«... Si më rekrutuan, ata më detyruan të kthe-

hesha në atdhe dhe të vendosesha në një fshat kufitar për të bërë detyrën e ndërlidhësit. Kështu, unë u martova për të mos lënë dyshime. Për disa vjet kam kryer me lehtësi ato punë që më ngarkonin, por pastaj filluan të kërkonin më shumë nga unë:

«Ç'po bëhet në fshatin tuaj?» — më pyeste «Xhindi»

«Janë ngritur të gjithë e kërkojnë të formojnë kooperativën» i thosha unë.

«... Kooperativa në fshat nuk duhet të krijohet! Në qoftë se ata duan të bashkohen, ne duhet t'u pregtisim «pyka» të forta, që t'i përçajmë» më tha një herë «Xhindi» që për këtë më dorëzoi edhe planin konkret të veprimit.

Plani ishte i thjeshtë dhe nuk kërkonte mundim e sakrifica, por vetëm kujdes e mprehtësi!

Sabri Tulçaku e Tafil Aldushi ishin shfaqur botërisht se ishin kryesorët që kishin mendime të kundërta për formimin e kooperativës. Atyre u dëgjohej fjala e kishin influencë, pothuajse të barabartë në fshat. Një përleshje midis tyre do të realizonte dhe përçarjen e fshatit e do të pengonte formimin e kooperativës.

Për t'ja arritur këtij qëllimi, Petraqi nuk bëri ndonjë gjë të madhe. Një herë futi dhinë e Sabriut në bahçen e Tafil Aldushit dhe u mjaftua me kaq. Disa ditë më vonë, pa e diktuar njeri, kaun e Sabriut, që e kishte lëshuar të kulloste andej nga lëndina e xhamisë, e shtyu pak e nga pak dhe përsëri e futi në bahçen e Tafilin. Tre çerek ore më vonë, fëmijës që kaloi andej, i tha të lajmëronte Tafilin se «i kishin hyrë kafshë në bahçe dhe po i bënë



batërdinë» dhe prapë u mënjanua. Përgjoi sa Tafili u largua, dhe kaun e dëbuar prej tij nga bahçeja, e tërhoqi në përrua. Këtu i theu këmbën e parë me hekur!

Mbas kësaj, në mbremje, shkoi në mes të fshatit — dhe pa vetë se si ata u mbërthyen me njëri-tjetrin. Nuk ndënji asnjans! Ishte ndër të parët që ndërhyri gjoja t'i ndante. Këtë e bëri sa për sy e faqe, se me zemër thoshte... «kokën hëngshi!»

Në mes të natës, atij që i dha shenjën e caktuar e që kishte ardhur e qëndronte i fshehur midis misrit të arës aty pranë shtëpisë së tij, i raportoi për ato që kishin ngjarë në fshat.

Më tej s'kishte nevojë për ndërhyrje, se «guri që mori tatëpjetën, patjetër do të shkonte në fund»! Dhe shkoi! U vranë ata që ishin parashikuar, fshati u përça! Simbas mendimit të kriminelëve formimi i kooperativës u sabotua dhe gjurmët e kriminit u mbuluan!

— Për ca kohë, por jo për gjithmonë — shtoi punëtori operativ, kur dëgjoi deponimet e të akuzuarit dhe kësaj here i bëri një pyetje tjetër, që të akuzuarin e mbërtheu me shpatulla për muri.

— Pse ta dha helmin «Xhindi»?..

Si i theu këmbën kaut dhe ndodhi grindja, ai vari mbi tel, në oborr të shtëpisë, një çarçaf të bardhë që të thahej se gjoja pa dashur mbi të ju derdh sapllaku me ujë. Ky çarçaf, që dukej prej së largu, ishte sinjali: «Eja në takim»!

«Xhindi», domethënë diversanti që vërtitej buzë kufirit erdhi në mes të natës dhe e thërriti me sinjalin e caktuar. Petraqi, që e priste në shtrat zgjuar, u ngrit ngadalë se mos e dëgjonte e shoqja

dhe në majë të gishtave doli jashtë. Mirëpo Dhimitrulla e ndjeu dhe ju vu pas. Ajo pa gjithshka nga larg po nuk guxoi t'u afrohej më shumë. Vetëm kaq i zuri veshi:

«... Kaut të Sabriut ja theva këmbën... Sabriu e goditi me pëllëmbë...» «Mirë, lere se e rregulloj unë!..»

Pastaj ajo u kthye shpejt në shtëpi dhe u shtri në dyshek, duke u shtirë sikur nuk kishte dëgjuar asgjë. Kur ndodhën vrasjet, u trondit shumë dhe të shoqit i tha hapur: «Ti e bëre këtë hata! Unë të dëgjova me veshët e mi! Shko lajmëro në qeveri se ndryshe do të lajmëroj vetë!»

Petraqi e mori me të mirë e ju duk sikur ja mbushi mendjen që «të mos bënte ndonjë budallallëk, se u shkatërrohej shtëpia», por kur e shikonte ashtu të menduar e pa qejf, e pa se ajo nuk kish hequr dorë nga mendimet e saj. Për këtë, pa humbur kohë, vuri në dijeni «Xhindin», i cili i dha urdhër të prerë që «ta qëronte sa më parë»!

Petraq Gangua zbatoi urdhërin. Ai veproi tamam si një gangster i vërtetë. Çdo gjë e mendoj me kujdes dhe e kreu me gjakftohtësi. Atij nuk ju drodh dora, kur i dha helmin së shoqes.

Trupi i Dhimitrullës së gjorë rrinte i qetë aty në dyshek ndërsa ai veproi me ngut për të fshehur gjurmët e krimit. I fshiu shkumën që i kishte buçitur nga goja e shenjat e tjera dhe pastaj nisi të derdhte lotët e korkodilit!..

Qau se «i vinte keq për gruan». E varrosi shpejt e shpejt, se kishte filluar të mbante erë!..

Sa më shumë ditë që kalonin, aq më tepër si-

gurohej se gjurmët e krimeve të tij do t'i fshihte koha, por u gabua! Kooperativistët dhe punonjësit e sigurimit të shtetit e mbërthyen atë dorë gjakso-ri, që akoma dukej sikur kullonte gjak! Gjak që rridhte nga një plagë e vjetër, e cila u operua me sukses

## MIRËNJOHJE E THELLË

«... Ja erdha, erdha... Ah! Po kjo mjegull që më ka mbuluar! Asgjë nuk shikoj!.. Ku është rru- ga? Këtej?.. Po, këtej duhet të jetë, se vjen dritë! Ja, erdha! Erdha! Ah! Prit pak se këtu paska baltë! Kush e ka hedhur këtu këtë baltë?.. Si? Dëgjohet e qarë? Vërtet? Pusho të dëgjojmë! Nga dëgjohet, andej?.. Shpejt, shpejt!.. Ku është?... Prit, prit pak, se më kanë zënë rrugën! Si, kush? Nuk e sheh? Ja ku është!.. Një kokë e zjarrtë. Sa e ma- dhe!.. Sa një pallat i madh!.. Ja, shikoi flokët e gjata... mustaqet e mëdha! Të gjitha i ka të ku- qe!..»

Mbas këtyre fjalëve ai filloi të mbulohej me djersë. Tha edhe fjalë të tjera, por ato s'kishin as- një lidhje me njëra-tjetrën e nga fundi i ngjisnin të nanurisurit.

— Po flet përçart — i tha mjeku infermieres, që po qëndronte e pikëlluar te koka e krevatit të të sëmurit.

— E shoh — u përgjigj ajo.

— T'i qëndrosh vazhdimisht pranë dhe t'i bësh të gjitha shërbimet e nevojshme siç të porosita.

— Si urdhëron, doktor!

— Herë pas here unë do të vij ta vizitohj. Sidoqoftë duhet të kesh kujdes të madh gjatë mungesës sime. Për çdo gjë që mund të dyshosh, të më vësh në dijeni menjëherë — e porositi infermieren ai për të fundit herë dhe u largua.

Kur hapi derën për të dalë nga salla e pavionit, ndeshi drejtpërsëdrejti në vështrimin e oficerit të policisë dhe të një gruaje, që priste e shqetësuar në korridor.

Mjeku që i pari që largoi vështrimin nga ata sy, që dukeshin sikur donin të depërtonin thellë në mendjen e tij, për të mësuar atë përgjegje që ata prisnin me padurim.

— Si është? — pyeti oficeri i policisë.

— Shpresoj të bëhet më mirë — u përgjegj mjeku, që uli kokën i menduar.

— Domethënë është rëndë, doktor? — e pyeti ai përsëri.

— Gjendja e tij është serioze — tha mjeku.

— Të lutem shpëtoje, doktor!.. Të lutem... Ai patjetër duhet të shpëtojë — ndërhyri gruaje me sytë të mbushur me lot.

Mjeku u prek shumë nga dhembja e saj.

— Do të bëj të pamundurën, motër!

— Të faleminderit! Shumë të faleminderit, doktor — tha gruaje me zë të mekur dhe nisi të largohet. Mjeku dhe oficeri e përcollën me sy. Aty te kthesa e korridorit ajo shikoi edhe një herë të dy burrat, që kishin qëndruar pa lëvizur:

«A do të shpëtojë? Vërtet do të shpëtojë?.. Mos më gënjen?..» Këto pyetje donte të shprehte vështrimi i saj. Mjeku, që kuptoi gjithshka, buzëqeshi me dashamirësi dhe i tundi kokën pa nxjerrë

asnjë fjalë. Gruas i shëndriti fytyra nga gëzimi! Oficeri dhe mjeku që mbetën vetëm, shikuan njëri-tjetrin në sy.

— E shoqja? — pyeti mjeku duke bërë me dorë andej nga ishte larguar gruaja.

— Jo, doktor — u përgjegj oficeri.

— Ndoshta e motra?

— Jo, jo!

— E mora vesh! Qenka ndonjë e afërmja e tij — tha mjeku, që u mat të largohej.

— Jo, doktor. Ai nuk ka asnjë nga të familjes a të farefisit të tij këtu në qytet!

— Po si shpjegohet shqetësimi e interesimi i saj? — pyeti mjeku pak i çuditur nga ajo që dëgjoji.

— Tani po ta shpjegoj ç'ka ndodhur — ju përgjegj oficeri dhe të dy burrat u larguan duke biseduar rreth asaj ngjarjeje.

\* \* \*

«... Era e fortë po shtynte gjithmonë e më lart shtëllungat e tymit të zi, që shpërtheu menjëherë nga dritaret dhe çatia e shtëpisë, e cila po përfshihej nga flakët. — nisi të tregonte oficeri i policisë. Midis dhjetëra qytetarëve të alarmuar, që u vërsulën për të shuajtur zjarrin, ishte dhe polici që sapo kishte mbaruar shërbimin e po kthehej për në rajonin e policisë. Shumë vetë përpiqeshin të hapnin derën e shtëpisë, që ishte mbyllur, kurse ai mori një shkallë të drunjtë, të cilën dikush e solli, dhe, pa humbur kohë, u ngjit lart në njerën nga dritaret. Aty filloi të përleshej me ato gjuhë të zjarra, që si dallgë të tërbuara, herë zvogëloheshin

e herë zgjateshin duke u bërë gjithnjë e më të rrezikshme!

Në një çast ato gjuhë u zgjatën, dhe sikur dikush të shtrinte ndonjë pelerinë të kuqe, u orvatën të mbulonin policin, por ai manovroi dhe u bëri ballë me guxim.

— Ki mendjen!.. Ruaju — i thërriti policit e llahtarisur një grua plakë, që pa pyetur për asgjë, u sul drejt shkallëve të drunjta që të shpinin atje lart te dritarja.

— Qëndro! Ku shkon, moj plakë — i tha një qytetar që i doli përpara — Nuk e shikon se është rrezik?

— Lermë! Po digjet djali — ju përgjegj ajo duke larguar dorën e atij që e pengonte të vazhdonte rrugën përpara.

— Mos u bëj merak, nënë — e qetësoi ai.

— Foli djalit të zbresë, se mos digjet — nguli këmbë plaka — Në djall të vejë shtëpia para djalit.

Burri u mundua t'i mbushte mendjen të largohet, por më kot. Ajo vazhdoi në të sajën duke i thërritur policit me sa fuqi që kishte: «Zbrit!.. Zbrit poshtë, të pastë nëna!.. Në djall të vejë shtëpia, se ngrihet përsëri».

Kështu vazhdonte të thërriste plaka, por fjalët e saj u mbytën në zhurmën e madhe të erës, të zjarrit dhe të britmave të shumta të njerëzve, që ndihmonin njëri-tjetrin.

Midis zhurmës e shqetësimit, u dëgjua britma e një gruaje që vinte me të rendur drejt shtëpisë që po digjej. Të gjithë kthyen kokën e vështruan atë që po afrohej pa frymë.

— Po kjo? — pyeti oficeri i policisë zjarrfikëse.

— Është e zonja e shtëpisë. Ka qenë në pazar dhe tani po vjen — u përgjigj burri që ndihmonte zjarrfikësat, të cilët erdhën atë çast e po shpejtonin për të shuajtur zjarrin.

Kur arriti pranë tyre, gruaja u mbajt m̄bas parafangos së maqinës zjarrfikëse sikur të mos kishte më fuqi të qëndronte në këmbë. Duke shikuar me sy të zgurdulluar zjarrin, ajo lëshoi një tjetër britmë të mekur!

— Qetësou, motër, se do ta shuajmë — i tha oficeri i zjarrfikësve, që i shkoi pranë për ta ndihmuar të ngrihej. Gruaja zgjati duart në drejtim të tij dhe bërtiti:

— Aman! Shpëtomëni vajzën!

— Vajzën?.. — pyeti oficeri i shqetësuar.

— Po — tha ajo — Vajzën e kam lënë brenda në shtëpi!

Fjala e saj i rrënqethi të gjithë. Njerëzit kthyen vështrimin nga ato gjuhë që donin të përpinin vajzën e vogël.

«Jo! Ne nuk ta falim atë! Ajo është jona» — tha me vete dhe polici që mësoi atë lajm ahëre kur po përleshej me zjarrin aty te dritarja. Për të shpëtuar vogëlushen, ai nuk priti por u hodh midis flakëve dhe hyri në dhomë. Guximi dhe trimëria e tij qenë të rralla.

S'kaloi veçse një kohë fare e shkurtër e në dritare u duk ai, që me gjoks kishte çarë flakën. Mezi merrte frymë. Kur e panë duarbosh, të gjithëve u shkuan të rrënqethura në trup por hesh-



tën! Vetëm gruaja e porsa ardhur lëshoi një britmë të lehtë therëse duke kafshuar gishtat e dorës.

— Ku ndodhet fëmija — pyeti polici, që gulçonte.

— Në dhomën matanë! Aman, shpëtomë vajzën — tha gruaja, që ishte bërë si e çmendur nga tronditja.

— Do ta shpëtojmë — u përgjegj polici, që u zhduk brenda midis shtëllungave të tymit të zi. Atij i shkuan në ndihmë zjarrfikësat. Oficeri, që drejtonte aksionin për shuarjen e zjarrit, forcat kryesore i përqëndroi aty ku ishte në rrezik jeta e njerëzve. Kordonët e trashë të ujit me presion, nisën të përplaseshin me furi brenda në dhomë për t'u hapur rrugë atyre që pritej të dilnin, por... minutat kalonin!

«— Ah! Shumë po vonohet!

— Prit! Ti qenke e paduruar!

— Mos i ka ndodhur gjë?

— Jo! Ai është trim!

— Do ta shpëtojë dot vajzën?..

— Patjetër!

— Po sikur...

— Pse të shkon mendja për të keq!

— Shumë u vonua!..»

Në ato çaste agonie të vërtetë, kur s'dëgjohej gjë tjetër veç zhurmës së presionit të ujit, njerëzve që prisnin jashtë, tek po bluanin në kokë këto mendime, filluan t'u shkëlqenin mbi ballë rruaza djerse! Ahere kur dukej sikur kishte ndaluar dhe frymëmarrja e tyre, në dritare u duk polici me fëmijën ndër duar!

U dëgjua një «Ah!» i lehtë si në kor, pastaj një urra e fortë shpërtheu nga të gjithë. Njerëzit s'dinin ç'të bënin nga gëzimi. Fëmijët po brohorisnin akoma. Plaka, që pak më parë i kishte thërritur policin sa kishte mundur, tani me shaminë që kishte në dorë, fshinte lotët që i rrëshqisnin mbi faqe. Ata ishin lot gëzimi.

Duke mbajtur me kujdes fëmijën ndër duar, polici, me mundim po zbriste shkallët e drunjta, poshtë të cilave e priste gruaja me duar hapur. Kur ai vuri këmbën në tokë, ajo u zgjat të rrëmbente të bijën që ishte shtrënguar fort pas kraharorit të shpëtimtarit të saj dhe sikur s'donte të shqitej prej tij. E jëma e mori dhe e mbuloi me të puthura vogëlushen, që s'kuptonte asgjë çfarë ndodhte.

— Tani forca, shokë, të shuajmë zjarrin — u dëgjua një zë. Polici që shpëtoi vajzën, u nis të ngjitej përsëri lart për të ndihmuar zjarrfikësat, por ndjeu dhembje të forta në duar... në fytyrë!.. Me vështirësi hodhi disa hapa por, sa arriti në shkallët e drunjta, ju morën mendtë!.. Ju duk sikur ato shkallë u vërtitën si ndonjë fugë dhe u rrëzua!..

Njerëzit që u ndodhën pranë, u grumbulluan rreth tij dhe e muarën ndër duar. Në fytyrë, në qafë, në gjoks, në duar filluan t'i dalloheshin fulltaka të kuqërreme! Nga dhembjet humbi ndjenjat!

— Shpejt, në spital! — tha njëri nga ata që e mbante në duar — Është djegur shumë.

Po, ishte djegur shumë. Asnjëri nuk dinte se çfarë i kishte ndodhur atij aty brenda, midis flakëve!

... Herën e parë, si kishte çarë përmes flakëve dhe kishte hyrë në dhomën që ishte mbuluar nga tymi, kishte parë se kishte qenë e kotë të sorollatej pa e ditur se ku ndodhej fëmija, prandaj qe kthyer nga kishte ardhur. Kur e mësoi këtë, ishte sulur me të shpejtë drejt vendit që i kishin treguar, por brenda atyre minutave të humbura, në dhomën ku ndodhej ishte grumbulluar aq tym sa që jo vetëm nuk shikonte rrugën, por i merrej dhe fryma.

U mundua të gjente derën për të dalë në korridor, nga do të shkonte në dhomën tjetër, por nuk kishte parë asgjë. Duke kërkuar sikur të ishte pa sy, e kishte kuptuar se minutat kalonin e ato ishin të shtrenjta. Nga çasti në çast çdo përpjekje e tij mund të ishte e kotë. Këto mendime e shtynë përpara me aq forcë sa që qe përplasur mbas murit. Aty kishte kërkuar me duar dhe më në fund kishte gjetur derën të cilën e kishte hapur me rrëmbim, por... e kishin penguar flakët që kishin arritur deri në tavan. Po digjej dyshemeja në hyrjen e dhomës ku ndodhej fëmija! Nga ajo që shikonte, ju duk sikur çdo gjë kishte marrë fund.

«Domethënë duhet të kthehem duarbosh?»

«Ta le të digjet?»

«Jo, kurrë!»

«Kot e ke! Rruga është prerë, nuk e shikon?»

Vërtet rruga ishte prerë. Dyshemeja që digjej po binte copa-copa poshtë në katin e parë. Për një çast ai kishte ndalur dhe kishte shtrënguar nofullat.

«Pse u ndale?»

«Ke frikë?»

«Jo!»

«Ahere ç'pret?»

«E dëgjove si të tha ajo nëna: «Shpëtomë vajzën?!»

Të gjitha këto i kishin dhënë forca, ndaj kishite vepruar me aq guxim e shpejtësi sa që edhe vetë nuk e kishte kuptuar se ku i kishte gjetur ato energji. Me një të kërcyer, kishte shkelur midis thëngjijve të ndezur dhe që përplasur në dyshemenë e padjegur të dhomës. Në atë copë rrugë që kishte bërë deri te krevati i vajzës, kishte ndjerë sikur një mori gjilpërash e kishin shpuar në fytyrë, në duar dhe në gjoksin e zbuluar, por ai s'kishte patur kohë të mendonte për to! Para tij ndodhej krevati mbi të cilin fëmija flinte krejt e qetë. E kishte rrëmbyer dhe kishte dalë nga dhoma. Zjarrfikësit, që e kishin pasuar, i kishin hapur rrugë dhe kthimin e kishte patur më të lehtë. Kur kishte dalë në dritare me fëmijën, sa s'kishte fluturuar nga gëzimi. Nga ai gëzim i kishte harruar fare dhe dhëmbjet e plagëve të rënda që më vonë e kishin lënë pa ndjenja.

\* \* \*

Prej kësaj ngjarjeje tjetër të papritur, gruaja, së cilës ju pre gëzimi në fytyrë, lëshoi fëmijën nga duart dhe s'dinte se si ta ndihmonte atë që i kishte shpëtuar të bijën.

«... Unë jam fajtores! Unë jam fajtores» mendon-

te ajo me vete «Ky sakrifikoi jetën për pakujdesinë time!»

Ndërsa po e shikonte ashtu pa ndjenja, u kujtua që as që e kish falënderuar fare për aktin e tij atë njeri me zemër të madhe.

\* \* \*


Atë ditë, mbas gati një jave, dhembjet i ishin pakësuar e polici ndjehej më mirë, Si nëpër ëndërr i kujtohej atij ajo ngjarje që e kishte sjellë aty, midis njerëzve me bluza të bardha. Nuk mban-te mend se çfarë i kishte ndodhur më vonë, por gëzimi se shpëtoi fëmijën i kishte mbetur i freskët ashtu siç ishin të freskëta dhe lulet që i kishte sjellë Mimoza e vogël, e cila qëndron para tij, në prehërin e së jëmës.

Tek i zgjati atë tufë lulësh, ajo dukej sikur **mundohet të largonte copat e bardha që e pengonin të shikonte fytyrën e shpëtimtarit të saj, por s'mundej.** Atij njeriu të mbështjellë me fasho të bardha — sikur t'i kishin veshur ndonjë skafandër — i dukeshin vetëm sytë, që i shkëlqyen edhe më shumë, kur doçkat e vogëla vendosën mbi jashtëkun e tij buqetën me lule në shenjë mirënjohjeje të thellë!

FUND

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Në kthetirat e shqiponjave .....	5
Në kërkim të së vërtetës .....	33
Midis qarkut të kuq .....	52
Operacioni i një plage të vjetër .....	90
Mirënjohje e thellë .....	110



PS 86